



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË NËNTË Ë TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.10.2022 (e Premte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Ekrem Ymeri, Arbnora Hajredini, Jakup Demiri Liridona Bislimi, Sejdi Emimi, Nexhat Halili, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Majlinda Shabani, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete RamaVeton Ramadani, Anisë Zejnullahu, Reshat Azizi, ndërsa mungoj Taibe Ibrahimimi, Sokol Shaqiri Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e nëntë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, gjatë kësaj periudhe kemi konfirmimin e ligjshmërisë së shumicës së akteve, mirëpo te rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba kërkon një plotësim të disa drejtorive. Për sot nuk e kemi në seancë, besoj që në seancën e ardhshme do të vjen. Te çështja e vendimit mbi obeliskun për Medelin Albrighte, i kanë kërku do dokumenta shtesë, që është veç në shqyrtim deri sa të vjen vendimi përfundimtar nga ministria, edhe kemi dy pika të tjera, shpallja për zonë me interes që na vjen për plotësim, sepse kanë kërku që të jetë edhe Ligji mbi Shpronësimin dhe të plotësohet e kemi edhe piken për këtë që do ta diskutojmë më vonë. Çështja e diskutimit publikë të planit zhvillimor na u ka rikthyer prapë që të del në diskutim publik, sepse kanë kërku forma e publikimit të jetë përmes formularit që është nga ministria nuk është në harmonizim me atë formular. Para se të fillojmë me rendin e ditës vazhdojmë me pyetje përgjigje, duke kërku që të mbahet rendi të respektohet.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Unë i kam 3 pyetje, se njëra ka hi në rend dite sot për shkak se kanalizimi që vjen prej Komunës Kaçanikut është ndal në Sodovinë. Ashtu kemi pas problem edhe me kanalizimin e Verbanit që është ndalë edhe ai në Sodovinë është ende aty, po ky i Begracës është ndal në pronë private në Sodovinë. Te Bislim Shabani ky ka problem që ju ka ndal në ara ose ne të shkon drejtori i inspeksionit ne ta kontrollon se nuk qenka këtu se aty ndalet si të ndalet reka është e mbulume me therra me çdo sen nuk mundet me kalu uji aty pari, ndërsa e dyta zotëri kryesuesi i VV-së që ja kam bë një pyetje më herët. E treta është nënkryetarit rruga “Sylejmani edhe Hajdini”, është blloku prej kanalizimeve. Kush e ka shti para 3-4

viteve ajo është e bllokume, është në agjendë për me u shtru, por kur është kjo është e 4 herë që bëj pyetje hala përgjigje nuk kam për këtë.

z.Illir Zuka: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! I kam dy pika para se me hi në to e dijë që jemi ka e teprojmë pak, por problemin e shkollës së Pozheranit e dimë krejt. Shpresuam shumë që me shpalljen e tenderit edhe të gjitha ato procedura që përfundun, se një mend do të kryhet edhe ajo shkollë që është bërë qe 7 vite, domethënë e ka kalu çdo kufi tash me vendimin e fundit jemi të informum krejt, se ajo është shku në OSHP edhe dojnë me shku edhe disa muaj dhe mos me pas një përfundim. Çka është më e dhimbshme, në momentin që është shpallë tenderi dhe është shpallë si një fitues, njëra prej deputeteve lypj debati publik në plus televizion prej administratorit Pozheranit dhe drejtoreshës së arsimit. Eja diskutojmë se, ne pe përfundojmë shkollën pa i mëndu këto gjera tjera çka mundën me ndodhë e gjë që ndodhen. E tjetra sen është shumë e dhimbshme, kandidati për kryetar të Komunës së Vitisë nga radhët e Vetëvendosjes del në media dhe thotë se, të gjitha vonesat faji kryesor është i qeverive të kalume, harroj që i ka marrë 900 vota në Pozheran edhe nuk ju kërkon falje, nuk vjen me bashkëndje të gjitha ato hjeke çka janë tu i hjek qytetarët e Pozheranit ose nxënësat. Domethënë del në media thotë që, fajet i kanë qeveritë e kalume, e nuk e dinë se qe dy vite kryeministër i Kosovës është Albin Kurti. Nuk du me politizu, asnjëherë nuk kam dashtë me politizu, mirëpo ne kemi mbet me një pozicion që nuk dimë çka të bëjmë, ne e organizuam edhe një protestë, janë kanë mbi 500 komente në plus televizion, protestë e LDK-së, protestë e PDK-së, ju kam bërë ftesë të gjithëve, hajdeni bashkangjitu se ajo shkollë është gjyna se si ka mbet, por shumë pak kanë marr pjesë prej subjekteve opozitare, hiq asnjë, kjo është për dhimbje. Nën kryetar shkolla fillore në Pozheran është tu punu prej 12:30 deri 20:20 në mbramje. Kam kërku që të bëhet shënjimi i rrugëve për këmbësorë për shkak që fëmija janë shumë në rrezik, kam kërku në KPF nuk është bërë hala, po kërkoj prej drejtorit të shërbimeve publike, ndriçimi në shesh asnjë dritë nuk bënë, fëmijët dalin shkojnë nëpër shpi, por shumica janë tu i marrë edhe prind tu pritë me kerre, po bëhet kolona. Kërkoj urgjentisht fushën e futbollit, ku është e rregullume, është kërkesë prej arsimtarëve të Edukatës Fizike, se nuk po kanë ku me i mbajt orët, tu e ditë se prej orës 17 po terrohet edhe me intervenu me i ndreq ndriçimin edhe te fusha që e kemi të shtrume me gumë. I kemi edhe 2 rruge në Pozheran, rruga “Ibrahim Pira” edhe një pjesë “Sadik Alidema”, a priten me u shtru këtë vit për shkak se janë kanë në projekt për 2020-2022. Kaq kisha.

z.Zejnepe Osmani: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Jemi në muajin tetor, muajin e ndërjegjësimit kundër kancerit të gjirit. Së pari e shfrytëzoj rastin të falënderoj dhe të ju uroj shërim të shpejtë për ato të cilat janë me kancer të gjirit, pastaj edhe ngushëllime ato të cilët kanë humbur anëtarët e familjarët e tyre. Kanceri i gjirit është një s’mundje që nuk njef moshë as racë, prandaj në momentin që prek një grua duhet të drejtohet në vendet adekuate. Unë dua të shfrytëzoj rastin sot, që të falënderoj të gjithë për këtë muaj që ishte me plotë aktivitete, ku me punën e tyre në teren janë munduar që të senzibilizojnë sa më shumë gra e në veçanti e përgëzoj dr.Vjollca Kadolli Halilin, e cila dha kontribut për një muaj, pastaj i përgëzoj të gjithë ata që mundësuan këtë memograf në Viti dhe për të gjitha në organizimin e marshit e cili marsh mblodhi shumë qytetar në një organizim të veçantë administrata komunale e kuvendit komunal me asamble, grupit të grave, Policisë së Kosovës, KFOR-it amerikan dhe të gjithë të pranishmit që ishin në përkrahje të këtij marshi. Respekt për të gjithë!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Është mirë me përshëndet edhe drejtoreshën e shëndetësisë, se kjo shkon përmes drejtoreshës. Tashti me ja nis me falënderime çdo këshilltarë, rendi i ditës jemi në pyetje përgjigje. Ka dy pyetje, keni mundësi, koha është për secilin.

z.Linidta Demelezi: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Pyetjet janë këto: kur do të rregullohet ndriçimi nga fshati Sllatinë në drejtim të Pozheranit, i cili ka mbetur në gjysmë? Duke e ditur se kjo rrugë është mjaftë e frekuentuar dhe nga nxënësit të cilët vijnë mësimet në fshatin Pozheran. Po e njëjta rrugë e ka të dëmtuar edhe trotuarin, gjë që vështirëson lëvizjen e këmbësorëve. Ndërsa pyetja e dytë është: kërkojmë nga organet kompetente që të sinjalizohen rrugët me shenja vertikale dhe horizontale, pasi që ato mungojnë në shumicën e rrugëve.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Unë çdo seancë që kam fol vetëm për problematikat e përgjithshme të Komunës së Vitisë, sot edhe unë po hi pak te lagjja ime, aty ku banojë unë te rruga “Hasan Prishtina”. Kam pas presion prej qytetarëve, banorëve të asaj lagje. Është një nder lagjet më të populluara në Viti, ajo vetëm po rritet me numër të banorëve, rruga e Pozheranit që thirret “Hasan Prishtina”. Ne kemi problem aty për trafik, rrymën e kemi jashtëzakonisht të dobët, është mirë me inicu që me pas aty një trafik. Tashti jemi në kohë të dimrit, kemi nevojë për ngrohje, aty duhet me pas një trafik, se ajo lagje e ka rrymën më të dobët në Komunën e Vitisë. E kam edhe një tjetër për ujësjellës, është lagjja që nuk ka fare, ujësjellësi nuk funksionon hiq. Është mirë se, ne e dimë që pa ujë nuk kemi as jetë. Unë e kam pas një takim me qytetarët, sidomos me të lagjes, ata që i kam afër, ata më kanë bërë një presion të jashtëzakonshëm që me pas ujësjellës. Një lagje më e madhe në Komunën e Vitisë mos me pas ujësjellës është tmerr. E treta, stadiumi i qytetit në Viti, unë pak mirrna me futboll edhe aty kam pas një shqetësim të futboll dashësve të Komunës së Vitisë, aty me shku ish si ajo fjala që e përdor falluxha. Unë nuk kam pa stadium më të keq, më të dobët, ish 0. Mu mi kanë siguruar edhe fotot, ish në gjendje të mjerueshme, nuk e di a është çështje politike, po a kanë fraksione brenda klubeve të ndryshme, por stadiumi është i qytetit. Unë e di që futbolla është si politika, janë këto fjalë që futbolldashësit mi kanë thënë që me i diskutu në Kuvendin Komunal të Vitisë.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam te ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në kuadër të kësaj kontrate është edhe trotuari të cilin po e potencoj gati se në secilën seancë e cila i lidh 3 fshatra: Trestenikun, Sodovinën e Muhagjerve dhe Sllatinën e Epërme. Në kuadër të kësaj po ndërlidhem me ndriçimin publik në Sodovinë të Muhagjerëve. Bëj pyetje, kur do të filloj implementimi i këtyre aktiviteteve. Pyetja e dytë është rregullimi i rrugëve rurale në Komunën e Vitisë. Në kuadër të kësaj po e potencoj edhe një herë, rruga “Ali Muhagjeri në fshatin Trestenik, e cila ka një distancë prej 300 metra, e cila besojë që nuk ka një kosto të lartë. Kur do të fillojë kjo rrugë dhe në kuadër të kësaj është edhe rruga “Beqir Kurti”, e cila është asfaltuar diku një javë para zgjedhjeve, vitin e kaluar, mirëpo sot ajo rrugë është tmerr. Kur do të riparohet ose rregullimi i asaj rruge kur do të bëhet?

z.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht kisha dashtë me u ndërlidh te kolegu Iliri, për shkak që, realisht shkolla e Pozheranit është një çështje e ndjeshme edhe si anëtare e komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, mirëpo edhe si opozitë po du me i shpreh qëndrimet tona që, gjithmonë kemi qenë pro zgjidhjes së këtij problemi, mirëpo e dimë që kjo do ndoshta një kahje tjetër. Kisha dashtë me i ndërlidh te puna e debatit ku e përmendi deputeten tonë, e cila është ftu me marrë pjesë në debat. Është mirë që debatet me u pa edhe në këndvështrime të tjera, për shkak që ndoshta në debat i cili kish mujtë me u zhvillu, pak a shumë kishin mujt me u detajizu problemet edhe mangësitë e punës, të cilat janë bërë edhe pse ka ngec puna deri këtu. Në seancat e kalume e kam pa shumë problematike zgjidhjen e këtij problemi edhe e në fakt kam propozu që me u bë një zgjidhje për sa i përket mbajtjes së mësimit, ku bëhet me ndërrime, e cila edhe kjo është një problematikë shumë e madhe për shkak që minutat të cilat mbahet mësimi, konsideroj që është jo efektiv. Domethënë qekjo ke e para. E dyta, në fakt e kam një ankesë te Drejtoria e Arsimit, ku ka të bëjë me konkursin e shpallur me datë 28.06, ku kem pasur një ankesë. Pe përmendi edhe emrin Nexharie Osmanit, e cila nuk është pranuar, në fakt ka bërë ankesë edhe i është refuzuar. Gjithashtu edhe ka bërë padi gjykatës themelore për prishjen e zgjedhjes së këtij konkursi. Kisha dashtë me pyet se, si është dallimi ndërmjet mësimit të mësimdhënësve, për shkak që kam pa gjatë trajnimit edhe me pikë të kriterëve. Ajo është me master, kështu që kisha dashtë një lloj shpjegimi rreth kësaj.

z.Musli Neziri: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Të jav uroj bexhat, po digjitale nuk kokan për me ndalë fjalën me respektu kohen, atëherë unë kam dy pyetje. Pyetja e parë është për drejtoreshën e arsimit dhe erdh pak me vonesë, por mirë bëri që erdh, sepse qysh janë rendit atje drejtorat krejt burra, kogjo pak frik për pamje me ju pa kështu, prandaj dil andej. Atëherë e dimë se, drejtoresh së fundmi janë pranuar në arsim 5 psikologë dhe janë pranuar 3 ndihmsa për mësimit të mësimdhënës mbështetës. Mirë që janë pranuar, sepse ka pas nevojë sidomos te pjesa e psikologëve, gjithashtu edhe te mësimit të mësimdhënës mbështetës. Këta mësimit të mësimdhënës mbështetës që janë caktu, nëpër

shkolla të ndryshme të veprojnë. A jeni të informuar që a janë tu e kry punën e tyre? Dhe konkretisht për shkollën e fshatit Terpezë: a është tu e kry mësuesi mbështetës ose mësimsdhënsja mbështetëse punën aty që e bënë dhe njëkohësisht psikologjia? Sepse ajo shkollë i ka 2 nxënësja që kanë probleme në të nxënimit dhe me nevoja të veçanta, dhe nëse mësimsdhënësi mbështetës është pranë për këtë punë, atëherë kërkoj që të dihet saktë a është tu e kry punën për të cilën është pranë në punë. Dhe e dyta, pyetja për nënkryetarin e komunës. Nënkryetar, së fundmi është bërë punë në fshatin Ballancë, rrethoja fushës gjoja se ka përfunduar edhe është postu në faqen e komunës, aty ende punimet nuk kanë përfunduar dhe kërkoj që aty ajo pjesë të përfundoj më shpejtë, sepse është nis kognitiv. Na kanë thanë 2 vjeçar, veç janë bërë 2 vjet aty që janë filluar punimet, prandaj ka ardh puna krejt në fund, mos ta prishmi për pak. Domethënë ka mbetur ende pa u kry rrethoja, gjitha pa u përfunduar dhe ndriçimi gjithashtu, e unë e di që në projekt është rrethoja me gjithë ndriçim. Domethënë nuk është kry, prandaj kërkoj që të përfundohet nga punëkryesi.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Atëherë, fillimisht pasi jemi në muajin tetor që është muaji i ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit, përmes ulars së kuvendit komunal, si kryesues e grupi të grave po shfrytëzoj rastin që të ju bëj apel të gjithë qytetarëve, por në veçanti grave të Komunës së Vitisë, të cilat sado pak në momentin që ndjejnë ndryshime apo kanë ndonjë parregullsi me shëndetin e tyre, të ju qasen organeve shëndetësore, pasi siç e dimë rasteve të fundit në bazë të analizave që janë duke u bërë, kanceri i gjirit ka një rritje mjaftë të madhe. Po flas edhe për komunën tonë, ndërsa unë nuk dua ta falënderoj askënd, por unë dua të ju bëj apel të gjitha instancave komunale, që mamografia e cila është sjellë në Komunën e Vitisë vetëm për 4 ditë, të ju jepet mundësia që kjo gjë të përsëritet edhe në muajt e tjerë gjatë vitit, jo vetëm gjatë këtij muaji, për shkak që ne e kemi parë që këto 4 ditë të fundit kemi pas kërkesa jashtëzakonisht të mëdha të grave, të cilat kanë ndje nevojë për ta bërë testin në mamografi dhe për shkak të ditëve të limituara dhe numrit të madh të ngarkesës, atyre i është pamundësuar që ta bëjnë këtë kontroll. Kam 2 pyetje për drejtoreshën e arsimit, kam pyetjet rreth bursave. Unë kam parë dhe kam diskutuar me student të komunave tjera fqinje, dhe në web faqet e tyre komunale kam parë që janë hapur aplikimet për bursim të studenteve dhe në disa vende me gjasë ka filluar të bëhet edhe shpërndarja e bursave. Ne e dimë që studentët kanë filluar tashmë mësimet e tyre dhe nevojat e mëdha janë tashmë të duhura. Tjetra, kam ngritur edhe disa herë më herët për transportin e nxënësve të vendeve rurale. Para disa ditëve kam takuar një nxënëse, i cili uedhton në shkollën e mesme nga fshati Stubëll dhe fatkeqësisht nga biseda që kisha me të, ai ka tregu që ka pasur 3 orë duke pritur për transport, për shkak se familja e tij nuk ka pasur mundësi për me ja largu udhëtimin. Kisha dashtë me ditë: kur do të bëhet zgjidhja e kësaj problematike? E kam përmend se para marrjes së mandatit të juv, qeverisja paraprake ka pas bërë zgjidhje për domethënë transportin nxënësve të shkollave të mesme në vendet rurale.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Para se me hi te pyetjet, e kam një kërkesë që është e adresuar për te ti si kryesues. Njoftimet që na vinë prej MAPL-së rreth rregullaritetit të vendimeve, propozim vendimeve. Kam një kërkesë që, në material të kuvendit të naj bini edhe njoftimin me shkrim së bashku me materialin, janë vendime që ne i marrim si kuvend. Po kërkoj që ta kemi edhe dëshminë fizike. Pyetjet nënkryetar, pasi drejtori nuk është këtu, e kam një pyetje rreth rrugës “Hasan Prishtina”, segment i rrugës që e lidhet me “Hasan Prishtinën”, ka qenë e buxhetuar në vitin 2019, ka qenë projekt 2 vjeçar, ka shku 2020, 2021 edhe 2022, jemi në fund. Në buxhetin që e kemi votu për 2023 nuk është e parapamë, nuk është e përfshimë. Kërkoj një informatë: çka dhe pse ajo rrugë nuk është përfunduar? Pyetjen tjetër, drejtorin e bujqësisë, janë shpërndarë, subvencionu bujqit dhe fermerët. Më intereson ta di, sa është vlera që janë subvencionu dhe me çka janë subvencionu. Kryesues, me lejen tane pe shkeli rregulloren, se e kam edhe një pyetje të tretë, pas 9 viteve për drejtorin e shërbimeve publike, ka të bëjë me çështjen e ambientit rreth “Eko higjienës”. A ka kërkesa dhe a kemi rritje sa i përket fshatrave, që janë hy në sistemin e mbeturinave? Se sa ma tepër që futen në sistem, do ta kemi një ambient shumë më të pastër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit z.Ali! Të gjitha vendimet konfirmimet, çka vinë që kthehen në rishqyrtim, do të ja bimi. Domethënë sikur na e kthen ministria, se edhe në email na i qojnë, ne i shtypmi edhe bimë prej seancës së ardhshme, ndërsa çfarë janë në konfirmim, vetëm naj kthejnë në konfirmim. Ajo nuk ka nevojë me ju dergu.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Unë sot më shumë kam disa kërkesa që prekin drejtpërdrejt interesin e qytetarëve të komunës sonë. E para është ajo që më ka ra në sy shumë here mu, besoj edhe juve, është një shtëpi përball çerdhes, që është mjaft e vjetërsuar dhe qatia e saj pothuajse e tëra është në trotuar. Të gjitha tjegullat e vjetra që janë, besoj që paraqesin rrezik permanent për çdo kalimtar, e sidomos për fëmijët që e dimë që është vendi, çerdhja aty. Kisha kërku që me marrë masa menjëherë Drejtoria e Shërbimeve Publike ose kush është kompetent, që me i sanu këto probleme. Përndryshe pasojat janë të pashmangshme, dikush do të pësoj. E dyta ka të bëjë me rrethojën e fushës së futbollit të shkollës së Germovës. Edhe ajo aty është pothuajse e demtume dhe e lidhur me disa litar, ku paraqet rrezik shumë të madh, sepse aty është vendi ku edhe fshati, po edhe nxënësit vazhdojnë aktivitetet e tyre sportive. Unë mendoj që edhe aty është urgjente me shku me intervenu deri sa nuk është bënë ndonjë pasoj e pariparueshme. E treta, është një kërkesë që kam bënë disa vite më herët, për një rrugë të shkolla në Goshicë, rrugë ku domethënë pjesa prej Goshices, Verban janë diku rreth 15 shtëpi aty, dhe nxënësit detyrohen që të rrugëtojnë mbi 2 kilometra me shku dhe me ardhë në shkollë, mirëpo aty është 200 metra. Domethënë lejohet rrugëtimi për në shkollë. Ajo që është përmend më herët edhe nga disa të tjerë, mirëpo do ta ripërsëris, është e domosdoshme që të bëhet një pjesë e tribunave në fushën sintetike në Sodovinë dhe Pozheran. Unë jam edhe fans i futbollit, mirëpo shumë here, po një, edhe kërkesa aty kur shkoj prej simpatizuesve që së paku të bëhen diku 300 ose 500, që të mundësohet dhe të kenë rahat kur të shkojnë me kqyr futboll.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kemi pasur 11 diskutime deri tash, keni bënë pyetje, besoj gjithëpërfshirja e mirë, ka pas komente, falënderime, begjat ja u kemi siguru me kërkesën tuaj, laptopat do të vinë në seancën e ardhshme, janë kry procedurat, jena tu i prit, Tashti vjen materiali edhe në laptopa edhe ai letësim do të bëhet. Kisha fillu njëherë me drejtorat në të përgjigjen, në fund mandej nënkryetari me dhanë një përgjigje.

znj.Fatbardha Emini: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! U bënë disa pyetje, kështu shkurtimisht edhe pse në takime që kishim me komunitetin për arsim, kemi diskutu rreth 2 orë për problemet, për sfidat edhe për punët e mira, por edhe për mangësitë, edhe ato që duhet me u përmirësu. Duhet me falënderu komisionin për arsim që, këto ditë kemi qenë bashkërisht në teren dhe kemi qenë në kontakt me interes të përmirësimit të gjendjes për interes të fëmijëve tanë. Në përgjithësi stafi mbështetës është për herë të parë, domethënë si komunë kemi angazhu mësimdhënës mbështetës, që në vitin e ardhshëm do të ketë edhe një numër më të madh. Ekipa komunale e vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, e kemi pa të domosdoshme, që më së shumti fëmijët kanë nevojë për mësues mbështetës, sesa për asistentë ne e kemi një klasë të veçantë që janë fëmijë pak me nevoje më të veçanta, ndërsa po mundohemi gjithëpërfshirjen në çdo klasë ta inkorporojnë. Kjo është kërkesë edhe e ministrisë dhe reformave të reja, që fëmijët që kanë nevoja dhe kërkesa të veçanta të jenë të përfshirë në mësimin e rregullt dhe në këtë po e bëjmë. Po e bëjmë duke angazhuar asistentë dhe mësues mbështetës, por edhe psikolog. Tani kemi raste pak më të veçanta që, kërkojnë një mbështetje pak më të madhe. Kështu që, jemi tu bënë përpjekje edhe për rastet që i përmende, jemi të njoftum edhe jemi në kontakt të vazhdueshëm edhe me shkollën që me i mbështet edhe më shumë, sepse janë fëmijë që kanë nevojë për mbështetje edhe më të madhe. Bursat, Liridona e ceki, ne gjithëherë i kemi shpallë në tetor, por kemi prit këto ditë të përfundoj, këto ditë të përfundon tetori, sepse në dorëzimin e dokumenteve, gjithmonë po janë të mangta, për shkak se regjistrimi i semestrave fillon me 1 deri 15 tetor. Disa universitete pe kanë prej 15 tetorit deri në nëntor, kështu që ka pas raste kur kompletimi i dokumenteve ka qenë i mangët me arsytimin se, nuk kanë arrit me regjitrseu semestrin. E dini që për me qenë përfitues i bursës duhet të jetë student i rregullt dhe ta dëshmoj me dokumente. Ne këtu javën e ardhshme do ta procedojmë, kemi pritë vetëm të përfudon tetori krejt për çështje që mos të ju mohohet

ndonjë studenti të rregullt përfitimi i bursës. Themi që për vitin akademik 2021-2022 ne kemi rrit numrin e bursave, përfituesve, por shpresojmë shumë edhe besojmë që për vitin akademik 2022-2023 do të jetë një numër edhe më i madh i bursave për studime, është pak më sfiduese arsimi i mesëm, për arsye se ne më herët kemi gjetë alternativa të tjera, edhe me donator i kemi mbështet, me subvencionim rastet e viseve rurale, jemi tu i shqyrtu edhe rastet e Stublles dhe Letnices, me i subvencionu përmes mundësive ligjore që janë subvencionimi nëpër drejtori të tjera, sepse në Drejtorinë e Arsimit nuk e kemi kodin e subvencioneve, e dini kur e keni votu buxhetin, domethënë duhet me gjetë alternativë të Drejtoria e Shëndetësisë apo te Zyra e Kryetarit, me i subvencionu lidhur me transportin, për shkak se vërtet e kuptoj që janë nxënës që kanë nevojë për mbështetje edhe të Stublles edhe Letnices. Gjithashtu ke një pyetje për rrethojat e shkollës, futbollit në Gërmovë. Konsideroj që në disa shkolla ka nevojë me u riparuar, sepse shumica e shkollave kanë rrethoja. Tani po, për vitin e ardhshëm është Berati, këtu i kemi planifikuar edhe rregullimin për 2023, riparimin e rrethojave në ato shkolla ku është paraqitë kërkesa nga drejtorët në këtë rast, sepse e dini që kërkesat vinë në DKA dhe planifikimet bëhen ashtu. Majlinda e paraqiti rastin e konkursit e dini se konkurset zhvillohen përmes zyrës së burimeve njerëzore. Unë me tregu të drejtën nuk jam shumë idhëtare me interpretu në këtë rast kur një rast shkon në procedurë pastaj, por meqë u bë pyetje, edhe shefi i burimeve njerëzore tash e 2 vite kompetencë e tyre edhe s'kam dëshirë në rast se këtu thatë që vetëm çertifikat e notave. Domethënë nuk ka diplom masteri, tashti unë nuk muj me fol më shumë se as nuk kam qenë në komision as vlerësues as absolut. Udhëzimi administrativ, sa e kam pa udhëzimin 2021 edhe masteri edhe fakulteti 4 vjeçar, të drejtë kanë në mënyrë të barabarat në procedurën e konkursit, përderisa ja mundëson të dyve me hi në konkurs. Nuk e di unë për rastin konkret, është në procedurë veç qëtu tashti po shof çertifikatë të notave. Nuk po shof çertifikatë të masterit, nuk kam ndonjë koment më shumë për këtë çështje.

z.Naim Pira: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Faleminderit Ali për parashtrimin e pyetjes lidhur me përkrahjen e fermerëve, bujqve dhe qytetarëve, kështu po thamë të Komunës së Vitisë. Kështu në përgjegjësi si drejtori e bujqësisë, në momentin e marrjes mandatit apo detyrës, jemi mundu që, buxhetin të cilin e kemi të planifikuar për me realizu në aspektin e subvencioneve jemi mundu deri diku ja kemi arrit qëllimin edhe pse kemi pengesa të natyrave të ndryshme fillimisht ka qenë projekt i vitit të kaluar diku 40 serra që është realizu këtë vit ka përfundua i kemi diku kanë qenë 40 qytetarë që fillimisht kanë perfitu mandej i kemi diku 50 qytetar apo bujq fermer kanë përfitu foli najllani për gjysmë hektari tokë që projekt i realizuar i përfundim mandej janë përkrah 18 qytetarë me nga 5 koshere bletë dhe ai projekt i realizuar janë përkrah diku 50 fermer me multikultivatorë në përfundim e sipër është edhe 100 serra do të thotë 100 qytetarë të Komunës së Vitisë, besoj deri me 5 sa kam informacion nga ana operatorit do të përfundojë projekti i 100 serrave këtë vit dhe natyrisht pagesa akoma nuk i është bërë dhe nëse i shifni pasqyrat financiare dikun del buxheti i shfrytëzuar apo i realizuar nga ana e bujqsis del dikun i dobët sepse pa implemetu pa e përfunduar projektin nuk kemi të drejtë me bë pagesa dhe me vet faktin që, dikund pa participim është vlera 52 mi euro do ta ngrite përqindjen e realizimit diku rreth 80% kemi edhe projekte të tjera një projekt që gjendet qysh nga muaji i 7 në Zyrën e Prokurimit është furnizimi me 60 spërkatëse 400 litërshe dhe 30 spërkatëse 45 litërshe. Lënda ka shku në OSHP dhe ju e dini janë periudhë të gjatë OSHP-ja ka qenë jo funksionale dhe akoma nuk e ka trajtu si landë dhe këtë aspekt jemi duke pas pengesa dhe tashmë për fund i kemi nga muaji i 9 dhe diku 4-5 projekte të cilat veç sa kam informacione nga Zyra e Prokurimit është bërë hapja e tyre, ka mbet të zgjidhet edhe përfituesi i saj, kemi të bëj dikun janë sa e di 30 mbledhës të barit, janë 50 shpërndarëse të plehut, do të përkrahen 50 fermer me mjelëse, ata që merren me kultivimin e lopëve do të jenë 40 inkubatorë dhe do të përkrahen 30 fermer me nga 5 koshere bletë, që do të thotë 150 koshere bletë dhe si total vlera do të kishte me qenë me participim 170 mijë euro. Por shpresoj shumë që procedura do të përfundojë dhe brenda afateve sa më të shkurta të realizohen ato projekte.

znj.Fatbardha Emini, drejtoresh: Më fal Ilir, nuk është që nuk dashta me u përgjigj apo vërtet ndoshta jo që është më e rëndësishmja, po është shumë më e rëndësishme jo vetëm në Komunë të Vitisë, po konsideroj që në nivel vendi nuk ka më të rëndësishëm se përfundimi i këtij objekti shkollor. Kanihere po mendoj që është

bërë si ajo ura e shejtë, a e din kaq shumë është zgjatë që është në procedurë të ankimimit dhe është në OSHP. Çka me komentunë një çështje që është në procedurë administrative, procedurë që kërkohet OSHP-ja njëfarë lloj gjykate për këto procedurat e tenderimit edhe vet fakti që shkum me procedurë të hapur, ne e kemi ditë që ka mundësi me pas edhe ankesa, se kemi përjashtu për atë edhe e patëm thirr këtu në seancë të jashtëzakonshme, me kqyrë me bë pak ma rast emergjent, që me i përjashtua procedurat dhe me shku me negocim. Unë shpresoj shumë që të paktën OSHP-ja ta ketë prej lendeve më me prioritet dhe ta shqyrtojë në afatin ligjorë sa më të shpejtë dhe të arrin me përfundim, sepse sipas njoftimit që kemi pas më herët, sepse tashti nuk kemi njoftim, por vetëm nga ajo që e kemi pas në sistemin e prokurimit, që është nxjerr një vendim edhe është pezullu aktiviteti deri në trajtim të çështjen nga organi i shqyrtimit prokurimit publik, që është OSHP-ja, definitivisht është shumë shqetësuese, por s'kemi kompetencë më shumë nuk mundem me gjetë fjalë Ilir e kuptojë jashtëzakonisht shumë shqetësimin edhe të prindërve edhe këshillit të fshatit, por edhe ne si institucione komunale nuk dimë se si me vepru më shumë, çka me bë. Definitivishtë ne në shkresën që kemi kërkun me shku jo me negocim ose me na bartë mjetet neve që ne me i përfundim procedurat, tashmë është në një procedurë që ka fillu. Nuk mundem me ndodhë këto asnjëra, sepse deri të përfundon kjo procedurë ne shpresojmë shumë që OSHP-ja ta shqyrtojë me prioritet dhe të përfundoj.

z.Basri Aliu, drejtor : Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Keni disa pyetje lidhur me drejtorin e shërbimeve publike. Unë do të mundohem të i jap ato përgjigje të cilat kem mundësi t'i japë. Iliri pyeti për ndriçimin në fshatin Pozheran, sheshi, nuk kemi pas njohuri në momentin që tash veç e kemi vet kontroll do t'i marrim të gjitha masat për me funksionalizu atë ndryshim, edhe pse tashti ka ardh një vendim i qeverisë, që do të jetë kufizim i ndriçimeve në përgjithësi që të njoftohen edhe asamblistëve, që duhet ndoshta edhe ti zbatojmë që, mos të jenë befasi edhe në qoftes ndërpritet dikun ndriçimi, ndërsa për te fushat sportive do të shofim edhe aty çka mujm me bë, do të intervenojmë, por po kem edhe telashe po ju them edhe ju mundemi me intervenu ndonjëherë prej qytetarëve të pandërgjegjshëm ndërhyjnë në orat elektrike të cilat janë për ndriçim dhe na paraqesin shumë defekte ose e lanë ndriçimin të jet 24 orë. Kështu që ne çdo kund në çdo moment nuk po jemi në gjendje me i ditë edhe ato, po është mirë me na informu që aty ku është kanë ndriçimi dhe gjatë ditës me na njoftu që të intervenojmë dhe të shofim se çka mundemi me bë. Ndërsa Aliu më pyeti në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Ali, të them te drejtën ne jemi në rritje të menaxhimit, domethënë është në përmirësim e sipër edhe pse ka ende punë për tu bërë, por ju kisha lutë të gjithëve, edhe pse me drejtorin e inspektoriatit jemi tu punu në teren, domethënë në gjetjen e njerëzve që po i hedhin mbeturinat në vendet ku nuk është e parapamë. Diku diku kanë intervenu edhe inspeksioni dhe i kanë denu kështu që kemi fillu gradualisht të punojmë në këtë drejtim, po shpresojë që në të ardhmen të jetë menaxhimi edhe më i mirë, po tu ju lut edhe juve të gjithëve aty ku jeni në vendbanime të angazhoheni në këtë drejtim, sepse ajo është në dobi të gjithë qytetarëve.

z.Adnan Ymeri, drejtor: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Nga asamblistja Lendita Demelezi është bërë një kërkesë mjaft e arsyeshme, domethënë rregullimi i sinjalistikës, për arsye se një ndër faktorët të cilët ndikojnë në uljen e aksidenteve është edhe rregullimi i sinjalistikave. Komuna e Vitisë dhe Drejtoria e Inspektionit i kemi të përcaktume edhe në buxhet edhe në kontratë që e menaxhojmë për rregullimin e sinjalistikën që e kapin vlerën e 47 mijë eurove. Deri më tash nga kjo kontratë ti kemi shpenzu 43 mijë euro, domethënë nga muaji janar e që pritet të punojmë deri në muajin dhjetor, duke pasur parasysh edhe kushtet atmosferike përparësi ju kem dhanë vendet që janë më të frekuentume siç janë vendkalimet të cilat vetëm janë shenjezu me dy ngjyra, ngjyrë të bardhë dhe të kuqe mos ta përjashtojmë edhe vendet të cilat janë të rregulluara vetëm me ngjyrë të bardhë. Gjithashtu kemi punu me vit të mesit me ngjyrë të bardhë kemi punu me vij të mesit me ngjyrë të verdhë, kemi rregullu edhe shejat vertikale, mirëpo sië dihet gjatë gjithë kohës ato dëmtohen, prishen, ndërsa ne jemi aktiv që t'i rregullojmë nëse hasim në ndonjë shenjë që është me ndonjë vend të ndjeshëm, ne i marrim parasysh dhe i rregullojmë.

z.Basri Aliu, drejtor: Edhe Sejda e bëri një pyetje para çerdhes atje ajo shtëpia, ne do të shofim do ta paraqesim ekipen që është për emergjenca për rrezikshmëri me parapa, ndërsa edhe me drejtorin e inspeksionit do të bisedojmë pasi që është pronë private në mënyrë që aty të intervenojnë edhe ata vet pronari në këtë drejtim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Me gjithë respektin për krejt shqetësimet të cilët u adresun se krejt pyetjet të cilat drejtohen ekzekutives në rastin e mbajtës së kuvendit janë shqetësime të qytetareve që ju jeni përfaqësues të tyre, megjithatë do të fillojë nga e para të cilat janë disa probleme, ndoshta për kundër vullnetit është problematike me zgjedh Basria e ngriti çështjen e kanalizimit Begraces, nuk ka mundësi tjetër përveç se ujësjellësi mundë të shkon edhe përpjet kanalizimi, shkenctarisht duhet e kërkon ramjen e vet. Fillimisht ka pas një protestë delegacionit Sodovines Querkezeve që kanë qenë 2 here dhe kanë ftu edhe kryeartin e Komunës së Kaçanikut që kanë qenë së bashku me drejtoret dhe e ka marrë miratimin e Sodovines Querkezeve të cilët e kanë pranuar se jo aty po ka qenë e parapamë me u bë derdhja po diku 1 kilometër jashtë atij vendbanimi se fillimisht ka qenë dikund te një urë si ma kanë spjegu kanë qenë shpiat afër dhe pakryes e ka pranuar një çështje të tillë, por mundësi tjetër këto lagjet e Begraces janë në këtë pjesë me u kthy dhe me shku ka Gerlica, nuk paska tasht kështu, është gjendja sikur e jona që derdhet në Moravë e që në Gilan ashtu është edhe pozita gjeografike tash ku ta qitsh jashtë vendbanimit 1 arë ma ke qenë a ka me qenë e Hasanit a e Jakupit dikujt ka me qenë ajo që ka qenë si ujudi e jonja me largu prej lokalitetit në lokalitet të mos pengon që kanë pranuar edhe banoret e Sodovines Querkezeve. Në këtë rast, por tashti që pe pengojka një arë tjetër se ajo dikan ka me pengu. Çështja e rrugës “Sylejmani dhe Hajdini”, kanalizimi i bllokuar, ne tashti e kemi lidhjen e një kontrate që është edhe drejtori këtu për mirëmbajtjen e atyre. Është mirë drejtor me evidentu në Sodovinë të Jerlive dhe me qu atë kontraktuesin me kqyrë me zhblloku në rast se kemi bllokad të kanalizimeve. Ilir mu dokë e morre përgjigjen, si institucione komunale besoj e kemi bë atë që neve na përket që, është me falënderu edhe kuvendi ekzekutive, thirrja e kuvendit të jashtëzakonshëm, dërgimi i shkresës të cilën e kemi dergu edhe te kryemistri edhe te ministrja e arsimit, megjithatë gjendja është kjo që është, unë do të lidhem edhe atje edhe thirrja e një debati nuk do ti kisha pritu për çfarëdo debati me qenë ndesh me deputeten, por nuk shtrohet debati aty ku ti nuk ki mundësi me zgjidhë problemin, problemin nuk e zgjidhë niveli komunal por ai qendror, për shkak se është investitor dhe nga këtu i thamë deputetes shtroe debatin aty ku e ke vendin në kuvend edhe rregulloje këtë punë. Nuk du me i fajsu mos, u ndal Ilir se unë jam një që e përsëriti është një thënie e imja personale, unë nuk e ndërtoj të ardhmen duke e vajtu të kalumen, nuk është tu më interesu fajtori, është tu më interesu nxënësit e Pozheranit me shku në orë normale. Besoj se për rrugën Ibrahim Pira dhe tjetrën do ta marrësh në seancën e ardhshme, se pa e pas informacionin e plotë nuk du si nënkryetar komune me thanë të pa vërtet një këshilltarit. Zejnepe, jo veç drejtoreshës, po krejt ato të cilët jeni involvu në atë muj ju përgëzojë dhe ishalla të gjitha ato të cilat janë të prekura shërohen sa më shpejtë, këtë rast do të isha pajtu që e përsëriti ta kemi hemogramin me siguri me shiqu në aspekt statistikor, minimumi ti i ki 10 mijë gra në Komunën e Vitisë që me pas të përhershëm në dhjetorë me bë një kontroll memografi është e nevojshme, por megjithatë këto janë mundësit në Kosovë dhe në Viti, dhe prandaj për krejt atë angazhim maksimal ato ligjërata, unë besoj që do të ju shërbejnë edhe ma afër me njoft problematiken rreth sëmundjes ndoshta te Lendita te Nexhati e përafërt do të jetë përgjigjja. Unë e kam thanë shumë herë sivjet ka qenë një prej viteve më të vështira prej kur punojë në pushtet lokal, për shkak se lufta në Ukrainë, ngritja e çmimeve, shprazja e Kosovës, ta them lirishtë kompanive punëtorët po ju mungojnë tashtë, këto të gjitha janë rregullimi i ndriçimit publik, e kemi një operatore dhe tashti kur do t’i vjen radha Sllatinës apo Trestenikut me trotuar dikun janë tu punu dikun nuk janë duke punuar, por megjithatë trysnitë tona janë të vazhdueshme që të kryen sa më parë. për rrugen “Beqir Kurti”, dhe tjetrën, edhe ti ki me marrë informacione, të kallëzoj saktësisht a është ne planë mu shtru sivjet apo jo, a për atë të cilën the e keni shtru dhe është demtu, unë besoj që garancioni është 1 vjeçar dhe do të ja shtrojë Zyrës Prokurimit që me qitë dhe me riparuar në rast se nuk e ka bë 1 vjet. Besoj Musli se do të bëjmë përpjekje maksimale që të përfundojnë ato projekte, se është edhe në të mirën e qytetareve, por edhe në të mirën tonë edhe do të jetë edhe një komision

për pranim teknik dhe pa u perfundu, me një fjalë mu shpreh, se kanë qare, por ajo që vlen me theksu binduni se ndoshta kur po thamë viti më i vështir çdo ditë çdo paradite nga 2 orë ne i marrin tu ju bë ne presion mbikëqyrësve, inxhinierave tanë që me ju bë presion, por nuk e rritin kapacitetin shkojnë qashtu një kohë i këna lutë veç me fillu me punu se janë kanë të gatshëm fillimisht krejt me lanë mos me fillu hiq, sidomos ata të cilët ia ka zanë projekti 2 vjeçar për shkak të ndryshimit të çmimeve dhe kemi këto probleme të theksuara. Duhet me i pranuar se si të tilla i shifni edhe ju e po i shofim edhe ne, megjithatë pa e krye nuk i pranohet dhe nuk e ka qare pa e krye, Ali edhe ty e kam lanë pikëpyetje, do të pyes. Për çështjen e segmentin rrugës “Hasan Prishtina”, se nuk kam informacion të plotë pse nuk është krye dhe a do të kryhet. Taulant, me të than 20 her 30 here e kam pas problemin e trafos. Do kohë më kanë pas ndegju shumë se, kishin nevojë ata. A e din kur po më dëgjojnë këta të KEDS-it, kur e kanë me javë dhanë ndonjë pronë për me ngrit, tani me i kushtëzua ti për diçka, përndryshe burrë nuk janë tu na ngu diçka fortë, se me siguri janë 10 kërkesa tona me adresë të kësaj trafte. E di problematiken, e di që është një prej lagjeve më të mëdha, e di që e ka këtë problem, jo sivjet po e ka qe 3-4 vite na përcjell ky problem. Çështja te ujësjellësi, nuk funksionin a nuk ka ujësjellës fare apo hiq, nuk funksionin, do të thotë nuk funksionin. Unë nga ky takim kur të dalë, do të bisedoj edhe më këta të ujësjellësit “Hidromoraves”, do ta thirri përgjegjësin dhe ta shofë se si e kemi gjendjen, dhe të jesh i bindur, në seancën e ardhshme do të jap përgjigje. Stadiumi i qytetit të Vitisë, si politikë kem bë përpjekje maksimale me ju orfu kushte, me ndërta një stadium. Përgjegjëshmëria jonë dhe formimi i këtyre grupeve të cilët me pengojnë edhe mu edhe në shkolla edhe në politikë ku do dhe na ka sjell me një situatë, ja u privatizua klubi, e ka blej prej këtij, e ka blej tjetri, na ka pru në një situatë të padëshirueshme edhe neve edhe ty edhe çdo njeri, pavarësisht a e përcjell sportin, po që e donë sportin. Megjithatë po bëjmë përpjekje me kontratën e ardhshme që ta kemi një punëtor aty që do të kujdeset për mirëmbajtjen e atij stadiumi edhe unë kam qenë idhëtar i asaj jashtë kompetencave. Domethënë ata që janë për mirëmbajtjen e hapësirave publike me mirëkuptim i kam qu me kositë atë bari që ish rritet e krejt ato, por megjithatë e kam pa nevojën e domosdoshme, një mirëmbajtës i cili mëngjes e fillon punën dhe deri te kryhet orari ai i rregullon karrikat që prishen dhe të kujdeset për te gjitha. Më kanë pengua edhe ato shkronjat sa e kemi ly që i kishin shkru, se këto me ndodhë në shoqërinë tonë nuk është mirë, por megjithatë duhet ta caktojmë një punëtor i cili ndoshta do t’i eliminon këto çështje kur të është rregullisht aty, deri sa të ngritet edhe vet kultura, se ajo pasuri është e të gjithëve e di që nuk e kemi në planë tribunat në Sodovine edhe Pozheran, megjithatë nashti si nevojë tashti me kalimin e kohës po behet se Pozherani do ta ketë stadiumin tjetër, që do t’i ketë tribunat. Nuk e di tashti, nuk guxojë me thanë para atyre të cilët janë inxhiniera, ka hapësirë edhe mundësi që të ju behet edhe këtyre, nuk e di. Në rast se nevoja e lypë, është kanë me rëndësi me i bë stadiumet. Tani edhe për tribuna me i ba 200-300 vetë. Unë nuk e di a lejon vetë stadiumi, se thirret stadium ndihmës, nuk është stadium për me i luajt ndeshjet futbollistike, nuk po guxojë me thanë kurgja, për shkak se profesionistët janë ata të cilët e thonë edhe duhet ta shikojmë mundësinë.

z.Illir Zuka: Drejtoresha e arsimit dul, e deshta me u nderlidh sipas informacioneve që kemi që jemi mundu me marrë domethënë si këshillë i fshatit në ministri edhe në OSHP. Na kemi informacione se, shkolla e Pozheranit do të bjen serish në pikën 0, për shkak se ka pas kur është dhanë tenderi, nuk është dhanë në mënyrën e drejtë, kështu që qëllimi që e ngrita unë ata ishke që, na bashkarishtë si kuvend, si ekzekutivë, si legjislativë bëjmë kërkesë që të bëhet kjo punë me negocim, se përsëri qato kompani, qato firma do të vazhdojnë me ankesa në momente që bjen në pikën 0, është lutje si Ilir, si qytetar, si administratorë, si këshilltar, që bashkarishtë ta gjejmë një zgjidhje që, të bëhet ajo punë me negocim ose të ju jepet mundësia që, Komuna e Vitisë ta shpallë atë tenderë, ne të kryhet me procedurë të shpejtë, kjo ishte lutja. Kryesues, edhe një lutje, për shkak se sot është tu transmetu lajv, kam shkrime të pa ndalura në telefon, është kanë edhe trotuari në Pozheran në 3 lagje, po kërkojnë me ditë qytetarët se, çka ka ndodhë me ta, është rruga deri te stadiumi, është deri te çerdhja Qifllak i lagjes “Pira” edhe lagjja “Zuka”.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Basria e ka bërë një pyetje në seancën e kaluar, megjithëse nuk qenka këtu, po unë përgjigjen po e jap, është pyetja rreth kycjes së autostradës në Gerlicë. Ne e kemi adresu në ministri, zv.ministrit, na i ka dhanë një shpjegim që, fazën e parë e kemi kry punën e hartimit të projektit, në fazën e dytë kur kemi fillu na kanë dalë prona private në atë zonë dhe tashti jemi tu marr me shpronësimin e 3 pronave private që na kanë dalë aty, dhe në moment që kryhen shpronësimi i tyre vazhdojmë me punët e tjera rreth implementimit të projektit. Projekti parat i ka te ndamë, të buxhetume, por vetëm se janë procedurat që duhet të kryhen për shkak të shpronësimit të 3 pronave private që kanë dalë në atë hapësirë ku ka me u bërë kycja e autostradës.

z.Musli Neziri: Faleminderit! Pata si vërejtje diçka me ngritë. Në momentin që ju bahen pyetje drejtorëve të digasterve të veçantë nga këshilltarët komunal, kërkoj që përveç përgjigjeve, ata në të rrinë këtu në ta presin replikën edhe tonën pak dhe jo vetëm e kryeta muhabetin temë edhe po dal jashtë, domethënë nuk po është e sinqertë, kjo nëse drejtoresha e arsimit nuk është tashti këtu edhe drejtorët e tjerë për mu nuk ka pyetje po heci. Ne nuk po themi mi ndalë me i stopu, por aty të cilët janë bërë pyetje, po kërkoj që të përgjigjet nënkryetari, po rri vazhdimisht këtu, gjitha përgjigjet po mundohet me i dhanë dhe po rrinë këtu, ndërsa të tjerat 2 pyetje i ka edhe ikë. Unë nuk dashta me ndërpre drejtoreshën e arsimit në replikën që pata, se është etike ta dëgjojmë çka po thotë për pyetjet që i bëjmë, jo të flasim si në oda, ne ta kryen ajo përgjigjen pastaj ne ta pret replikën për neve. Drejtoresha tregojke që i kena qu nja 3 veta mësime mbështetës dhe psikologë, unë po e di që i kanë qu dhe Komiteti për Arsim është marrë. Unë i kërkoja drejtoreshës që a është tu e kry punën që është shku, sepse aty kemi rast specifik, domethënë fëmija me nevoja të veçanta është në klasën e gjashtë, mbanë mësime me fëmijët e tjerë, ndërsa psikologjia dhe mësime mbështetës thonë se, ne nuk dimë se çka të bëjmë me këtë fëmijë. Prandaj, ky është shqetësimi. Nëse i keni qu mësime mbështetës a është tu e kry punën për çka është qu e jo të thuhet kena qu edhe dalim jashtë edhe kurgja kërkujt, ti the diçka unë thashë diçka edhe ne për ata asgjë mundohemi me dhanë rezultat aty ku drejtohen pyetjen ta dëgjojmë edhe replikën e kandidatit që pe shtron pyetjen këshilltarit komunal, në këtë rast dhe të jemi më të sinqertë mes veti, domethënë nënkryetari po rrinë, po mundohet 27 këtu sa jemi me ju dhanë përgjigje drejtori 2 pyetje edhe hec. Nuk është e sinqertë kjo, mendoj që duhet të jenë pak më të sinqertë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Plotësisht pajtohem, nuk diskutohet kjo jo për shkak apostrofimit tem, por duhet me qenë të përgjegjshëm, vendimet dalin nga kuvendi komunal që e obligon ekzekutiven, e obligon në këtë rast edhe nënkryetarin i obligon edhe drejtorët edhe drejtoritë, duhet të jenë të sinqertë tu i përjashtua kur ata kanë agjentë me leje që e kanë edhe mirëkuptimin e juve, përndryshe është mirë qeveria gjithëherë me qenë complete për shkak se edhe në aspektin ligjor edhe në aspekt teknik procedural e ndihmon kuvendin dhe në këtë formë shkojmë. Dhe unë këtë brengë të cilën e shfaq këshilltar, unë do ta themë në bord të drejtorëve dhe do të kërkojë edhe prej kryetarit, që kryetar obligojë drejtorat me qenë që muj me i obligu edhe unë me qenë gjatë seancës deri në përfundim të seancës, se të gjitha pikat e rendit e kanë rëndësinë e vetë, se mos me pas rëndësinë e vet nuk i bimë këtu hiq.

znj.Majlinda Shabani: Faleminderit shumë! Përpos që pajtohem me kolegun asamblist lidhur me praninë e drejtorive këtu, në ankesën që e bëra unë drejtoreshën e bashë që nuk ke shumë e informume për sa i përket rastit. Fillimisht po du me tregu që nuk kam diçka lidhje me personin në fjalë, përpos që e kam ankesën e saj dhe po e shprehi para juve për shkak që mendoj që duhet me pas lloj transparence të dy anshme. Ajo e pat për para certifikatën e notave, ndërsa unë e kam vërtetimin e diplomës këtu ku është e cekur edhe nota mesatare, e cila është 9 edhe nuk e di se si pranohet aplikimi i personave në moment që nuk janë të plotësime dokumentacionet, se ky ju ka nënshtruar provimit me shkrim edhe provimit me gojë. Domethënë kjo është.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Këshilltare, nuk e di a është rasti i njëjtë, por një të Mërkurë, tashti nuk e di me datë, kur e kemi me qytetarë, një prej ankuesëve e kam në fletore, por nuk du me apostrofu emrin, ka qenë e gjinisë femërore, ka qenë në zyrën time e ka shfaq këtë shqetësim. Tashti nuk pe di a është për të njëjtin

rast, edhe e kam marrë shumë me seriozitet, drejtpërdrejt pas takimit e kam thirr menaxherin e personelit më ka sjellë dokumentacionin. Tashti ai dokumentacion i sjellur në zyrën time ka qenë vetëm certifikata e notave, a ka diplomu pas afatit nuk e kam pas diplomën. Të lutem, vetëm du me skjaru, dhe dëgjo, më ka tregu se landën e kam qu në gjykatë, e kam përgëzuar me vazhdu, në rast se ku është ai fat e drejta e jote në rast se tu ka cenu dhe ti e fiton me gjykatë edhe kthehesh në vend të punës, edhe do të paguhesh për krejt këto muaj të cilët tu ka bërë padrejtë, megjithatë dokumentacioni që mua mu ka ofru, se më tregoj që ju ka refuzu, ka bërë ankesë, e ka refuzu komisioni, tha dhe rruga tjetër më ka mbetë gjykata. Thashë, në rregull është edhe gjykata është e jonja, drejtësia duhet të kërkohet deri në instancën e fundit veç dhashtë Zoti ishalla ke të drejtë ti si je anku, prandaj besoj që këtu jemi me një vend ti e ngrite si shqetësim ajo ma ka ngritë. Unë se kam ngritë në kuvend, po e kam ngritë në zyrën time, aty ku e bëj punën 8 orë dhe i kam marrë këto informacione, tashti në rast se ajo e ka, me siguri gjykata do ta bëjë administrimin e provave edhe momentin e shpalljes së konkursit edhe mbylljes edhe të diplomës, do të ballafaqohen edhe do të shiqohet mundësia. Nuk do ta debatohet pasi që lënda është në gjykatë, ishalla është në të drejtë.

znj.Majlinda Shabani: Faleminderit për sqarimet nënkryetar! Sa i përket datës është 22 mars 2022. Në këtë aspekt jemi në rregull, përveç se lënda ka kalu në gjykatë edhe shumë mirë që tashti gjykata merret, po kjo është edhe një vërejtje ndoshta për drejtoreshën, që pak a shumë me qenë e informime edhe mënyrën se si po pranohen këta të punësuarit.

znj.Lindita Demelezi: Faleminderit kryesues! I nderuar drejtorë, ju thatë nëse hasin në ndonjë shenjë që nuk është e vendosur, të na lajmëroni. Ka shumë, por njëra ndër to që ka pas edhe aksidente me fatalitet është ajo e fshatit Sllatinë në drejtim të Pozheranit, që nuk ka asnjë shenjë që kufizon shpejtësinë në hyrje të fshatit. E dimë që rruga është e drejtë, shpesh bëhen edhe gara shpejtësie aty, kështu që në këto hyrje të ketë shenja komunikacioni.

znj.Zejnepe Osmani: Për memogramin që ka qenë në Viti, 4 ditore, unë kam pyet aty, pse nuk ka mundësi më shumë që ato gra të bëjnë memogram, mu kanë përgjigj kështu për aty, që është ajo mjekja e cila e bënë memogramin, nuk guxon të rri ajo më shumë për shkak të rrezatimit që është aty edhe për këtë e kemi numrin e limitum të grave.

z.Sejdi Emini: Drejtori i shërbimeve publike është këtu. Te rrethoja e shkollës Germovës drejtoresha e dha një përgjigje, mirëpo mendoj që është një dëmtim i zakonshëm qysh dëmtohen, e intervenimet kanë ku me u bërë, mirëpo këtu nuk ka kohë me pritë gjatë turnirit që është mbajt, Milaim Tahiri, ka fryrë e madhe dhe njërin pjesë e ka këput pothuajse të gjithën, paraqet rrezik shumë të madh. Mendoj që është urgjente me intrvenu dhe me sanu problemin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Vazhdojmë me rendin e ditës, kuorumi është i mjaftueshëm, rendin e ditës e kemi marrë me kohë, besoj që e kemi lexu 6 pika që i kemi. A ka dikush me diskutu lidhur me rendin e ditës?

z.Musli Neziri: Para se me hi në rend të ditës, unë pata edhe diçka, edhe pse drejtoresha e arsimit nuk është këtu, unë kam kërku që sot të bjen raportin për fillim vitin mësimor. Nuk e di pse nuk është këtu, ne si komitet kemi qenë është e vërtet që kemi mbajt takim 2 orë, ajo tha si komitet që janë edhe koleget këtu prezent, po unë kisha dashtë që ajo të raporton sot për këtë pjesë që ne ta diskutojmë edhe atë pjesën se a është e vërtet atë të cilën e thotë ekzekutivi, sepse mendojmë që kemi pas edhe ne gjithçka flasim ku ta kishim përmbledh në një raport si komitet. Ne e dimë që do ta japim si raport në fund të vitit, megjithatë kisha prit sot që të jetë në rend të ditës, po nuk e di pse nuk ka ardh.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit shumë Musli! Ka qenë e planifikime që edhe informata për arsim të vjen për fillim të vitit shkollor, mirëpo nuk e kanë protokollu me kohë, se kanë bërë për me prurë në komitet edhe ka mbet pa u procedu për seancë. Është neglizhencë që po na e bëjnë dhe ne e kemi thënë, edhe në komitet kemi diskutu, e kemi dhanë vërejtje që pikat të na vinë me kohë nga drejtoritë, se më nuk do të vinë në seancë pikat. Nëse nuk vinë me kohë, se zakonisht po na vinë edhe në komitet do pika urgjente, pa nevojë po i vonojnë, po

rrinë kur po vjen dita e fundit po kërkohet kohë shtesë ose aty duhet me shti drejtpërdrejt për atë arsye kemi kërku që do të jetë për seancën tjerat procedimi më me kohë.

z.Illir Zuka: Kryesues, pikat na kanë ardh me kohë, mirëpo kisha lut prej sekretarisë, ki pikë që nuk mund të lexohet asnjë fjalë, nuk e di çka kena me mbrojt këtu, domethënë që për shkak që po him në rend të ditës, mos me cekë te drejtori, unë e di problemin se kam bashkëpunu me Fatlumin një kohë të gjatë, po megjithatë kryesues ti apo dikush tjetër duhet me marrë masa, se ki pikë që nuk mund të lexohet asnjë fjalë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kemi jashtëzakonisht këto probleme, problemi më i madh është kur na vie çështje me bë fotokopje materiali për me pru, nuk kemi zgjidhje tjetër, se e dini që edhe fotokopjet janë procedurë që vinë prej kompanive që është nga niveli qendror, që mirëmbahen. E kemi një gjendje katastrofë, nuk kemi qasje komuna as ne, ndodhë që 10 herë e bëjmë një kopje për me nxjerrë 1 kopje mesatare për me pru për atë arsye besojë që në seancat tjera vinë edhe laptopat që ta kemi më të lehtë, na mirëkuptoni edhe në këtë seancë.

z.Ali Bajrami: Kryesuesi e cekti edhe parafolësi Musa, takimi që kemi pas si Komitet për Arsim, Rini, Kulturë dhe Sport, ka qenë prezent edhe drejtoresha, jemi marrë vesh në atë takim që, për këtë seancë ta kemi edhe informatën për fillim vitin e vitit shkollor. Nuk është sjellë, nuk po hy me lyp fajtorin, po ne të mbetet si konkluzion që, për seancën e radhës të jetë edhe kjo informatë, se kemi çka diskutojmë dhe kemi çka debatojmë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit, unë kam pas takim me drejtoreshën pardje për këtë çështje, pikës për informatën edhe gjithqysh në seancën tjetër do ta kërkojmë me pru. Për këtë seancë kemi paraqit këtë:

R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt e KK-së.**
2. **Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Shtator 2022.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit UBT dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës së Vitisë.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit Nr.01-110/05-110 të datës 01.02.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit Nr.01-110/05-1067, të datës 28.09.2022, për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën kadastrale në Viti, Radivojc dhe Sllatinë.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shqyrtim publik projekt Planin e Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030.**

A jeni për këtë rendë të ditës me ngritje dorës? Të gjithë janë pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka. Domethënë miratohet rendi ditë.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a tetë e rregullt e KK-së**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të renditë të ditës. A ka dikush të diskutojë?

znj.Liridona Bislimi: Faleminderit Kryesues, atëherë sa i përket pikës së procesverbalit, gjatë seancës së kalume, sinqerisht na ka ndodhë që kemi pasur ankesa të ndryshme, qoftë për një fjalë të vetme pa kuptim, është e logjikshme kjo, mirëpo kjo çka ka ndodhë me diskutimet e mia, në fakt mu ka dokë shumë absurde dhe e papranueshme. Unë kam mbaj 3 diskutime, diskutimi për pikat jashtë rendit të ditës ka qenë në rregull, mirëpo diskutimi i 2-të gjatë buxhetimit komunal ku kam diskutu si përfaqësuese e grupit të VV-së, ku ka qenë një diskutim mjaftë i gjatë, nuk është askund, as edhe një shkronjë e vetme, ndërsa diskutimi i fundit për informatën lidhur me raportin e auditimit është vetëm një 20% i diskutimit që unë e kam mbaj. Tashti unë mund ta arsyetoj

ndoshta se, ka pasur probleme me dëgjimin ato ingjizime që i bëjnë, mirëpo ne kemi pasur edhe plus televizionin, i cili ka qenë këtu edhe e ka bë komplet seancën. Unë i kam postu ato video në profilin tim personal, të gjitha kanë qenë të dëgjueshme, diskutimi ka qenë i qasshëm, po nuk e di pse ka ndodhë kjo. Unë shpresoj që mos të përsëritet për shkak se është tu ndodhë shumë shpesh, jemi tu pas probleme të tilla, por sikur kjo nuk ka ndodhur asnjëherë.

z.Ali Bajrami: Rreth procesverbalit, unë kam kërku që takimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe për Komunitete dhe komitetet që janë formu dhe që janë aktive të botohen në webfaqen e komunës, faqe 2, publikimi në webfaqen e komunës është kompletë jo funksional. Mu pas kanë jofunksional këto komitete qysh kisha lypë me u publiku, po janë funksional, jo komplet jo funksional, vetëm këtë vërejtje e kam.

z.Jakup Demiri: Te faqe 18, e ki kur kom drejtu. Unë te puna e asfaltimit nëpër oborre te asfaltit në oborre është, mirëpo keni bë ndriçim publik nëpër oborre nuk e kam thënë nëpër oborre, por e kam thënë, keni marrëveshje me disa lagje për votë, kjo kishë thënë të hiqet, u bë ndriçimi publik nëpër oborre, se ndriçim publik nuk është, po është puna te asfalti, por asfalti mirë është, po te ndriçimi publik kisha thanë të ndryshohet.

z.Ilir Zuka: Pikë së pari kryesues, pak edhe prej respektit me qitë një z.përpara, se unë e di që ne nuk mundemi me thanë gjithçka, po kur të shkruhet procesverbali, ne kemi mbajti shumë. Shembull po lidhna me një pyetje për drejtoreshën Fatbardhë, domethënë ajo është femër jo mashkull. Me siguri këtu fajet i ka lektori, të njëjtën mënyrë, drejtoreshën Merrushe, znj.Merrushe Ahmeti ose drejtoreshën e QKMF-së. Edhe proces verbali me u rregullu, po del shumë keq kur po e lexon.

z.Perparim Sadiku: Përshëndetje për të gjithë! Është rregull në lektorim, që procesverbalet, në këtë rast ne e thojmë procesverbal, po në realitet është një përshkrim i fjalëve të juaja. Kështu që, nëse ju i thuani Fatbardhë, ne e shkruajmë Fatbardhë, nëse i thuani znj.Fatbardhë, ne e shkruajmë ashtu. Kështu që nuk kemi të drejtë me intervenu në rregullimin sintaksor, në aspektin drejtshkrimor rregullojë diçka, ndërsa në ndryshimin e të folurit nuk kam të drejtë, sepse mbi këtë dokument në të ardhëm dikush mundë të krijojë një punim shkencorë. Kështu që unë nuk kam të drejtë me ndërhy. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Duke i pasur parasysh të gjitha këto vërejtje, me plotësimin edhe të Liridones që, pjesa e saj nuk ka hy në procesverbal, të futet, të plotësohen këto vërejtje që janë dhanë nga të tjerët. A jeni që të miratohet procesverbali? Kush është pro me ngritje të dorës? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, të gjithë janë për. Miratohet procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Shtator 2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtori nuk është prezent, se është i sëmut, ka lajmru, dhe zyrtari i financave është këtu

z.Taulant Haxhiu: Unë nuk po e di se si është drejtori i financave i sëmut, kur dje në ora 11:35 e kam pa në sheshin te kafet në Prishtinë, te restorant *Tirana* tu pi kafe në ora 11:35 të natës. Ai i sëmut, çfarë i sëmuti. Nëse nuk e kam pa pramë në këtë kohë, unë jap dorëheqje prej kuvendit sot.

z.Berat Zuka, zyrtar i ZKF-së: Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Organizatat buxhetore janë të obliguara të paraqesin raporte financiare çdo 3 muaj, edhe atë duke u bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, neni 45, dhe Ligjin e Financave Publike. Në pasqyrat financiare i keni planifikimi i të hyrave, realizimi i të hyrave si dhe alokimet e buxhetit dhe shpenzimet. Në këtë proces 9-mujor shpenzimet kanë qenë në shumë prej 9 milion e 389 mijë e 476 euro, çka do të thotë, të gjitha shpenzimet në 5 kategoritë ekonomike në përqindje të alokimit të mjeteve, kapin një përqindje prej 83.32%, kurse alokimi i buxhetit ka qenë në shumë prej 11 milion e 269 mijë e 374 euro, duke i përfshirë të gjitha kategoritë ekonomike dhe fondet burimore në faqe 3, pjesa e parë e aprovimit të buxhetit, çka do të thotë se kemi një shumë prej 14 milion e 055

mi e 251 euro buxheti i planifikuar për vitin 2022 është 13 milion e 069 mijë 495 euro, çka do të thotë se kemi diferencën prej 985 mijë 786 euro. Kjo diferencë është konform ligjeve, sepse kemi pas bartje të buxhetit në shumë prej 682 mijë euro dhe të hyrave të donatorëve në shumë prej 230 mijë e 298 euro. Nga faqja 3 deri në faqe 13 kemi të gjitha të prezantuara shpenzimet dhe alokimet për secilin program buxhetor. Nga faqja 19 në pasqyrat financiare keni të hyrat buxhetore vetanake të komunës, të planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar-Shtator 2022, për të gjitha njësitë të cilat krijojnë të hyra vetanake. Çka do të thotë se, nëse e marrim planifikim e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2022 është 987 mijë e 868 euro. Nëse e marrim buxhetin e planifikuar për periudhën 9-mujore Janar-Shtator është 725 mijë e 505 euro, kurse alokimi ose të hyrat e grumbulluara janë në shumë prej 840 mijë e 943 euro. Çka do të thotë se për 115 mijë e 438.99 euro kemi tejkalim të planit për periudhën Janar-Shtator dhe totali i donacioneve për vitin 2022 pa i krahasu bartjet, është një shumë prej 219 mijë e 130 euro. Këtu përfshihet granditë e performancës komunale, nga faqja 21 kemi krahasimin e të hyrave vetanake me periudhën Janar Shtator 2022. Për të njëjtin periudhë me vitin 2021, çka do të thotë se, të hyrat kanë shënuar rritje në vitin 2022 për 24 mijë e 775.24 euro. Faqe 23, janë të prezantuara shpenzimet e investimeve kapitale që kapin një shumë prej 1 milion e 665 06.68? euro në faqe 26 dhe 27 e kemi krahasimin e shërbimeve për vitin 2022 me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Ne kemi një diferencë të shpenzimeve në shumë për vitin 2022, në shumë 890 mijë e 342.76 euro, në kategorinë ekonomike paga, mëditje prej 119 mijë e 900 euro; mallra dhe shërbime dhe komunal 445 605 euro. Totali i subvencioneve prej 123 mijë e 176 euro dhe investimet kapitale prej 201 mijë e 660 euro, çka do të thotë se në vitin 2021 kemi pas mungesën e zyrtarit të zotimeve dhe deri sa me alternativë kemi punu 1 muaj ditë, mirëpo derisa është gjet dhe është certifiku kemi pas mungesë zyrtarit, kemi vitin 2021, kemi ngecë me shpenzime, kurse vitin 2022 pas kompletimit të zyrtareve është kjo rritje e shpenzimeve të cilat janë bë në fund. E keni edhe listën sqaruese të kodeve ekonomike me sugjerim të Komitetit për Politikë dhe Financa, që t'i bashkëngjitet, sepse ka shumë shpenzime të cilat kodohen në të njëjtin kodë, mirëpo e kanë diferencën dhe shpenzimet e ndryshme. Faleminderit!

z.Ali Bajrami: Faleminderit për prezantimin dhe pasqyrimin e pasqyrave financiare Janar Shtator 2022. Unë nuk i kisha lodhë me shifra, se veç i përmendi parafolësi, por kisha dashtë me fol për të hyrat që është vlera 840mi e 943 euro e 99 centë ose në përqindje 85.13% besojmë që kjo vlerë do të përmbushet edhe do të realizohet në përqindje 100% që janë të hyra që inkasonë dhe që hynë në shërbimë direkt të qytetareve ose në vlerë planifikume për 2022 nëse e marrim në krahasim me 2021 kemi një rritje prej 24 mijë e 755 euro e 24 centë, që është mirë të shpenzimet buxhetore paga, mëditja. Ajo dihet por këto tjerat të alokuara dhe të shpenzuara kemi një shpenzim prej 83.32% që trendi është që edhe kjo të përfundojë, mirë ajo çka më ra në sy pagesa për vendime gjyqësore 624 mijë e 33 euro e 64 cent, janë direkt mjete që janë marrë prej buxhetit komunal që nuk është shumë e vogël kanë pas drejtë ligjore pikërisht këtu, ka të beje me arsim. Nëse nuk gaboj për shkak të atyre procedurave marrëveshjeve që janë bë të mëhershme që qeveria, ministria përkatëse këto mjete nuk pi alukon në buxhet të komunës dhe këtu po atakohet buxheti komunal të shpenzimet kapitale, është pak 62% edhe 9-mujorin ka përfunduar 3-mujori i fundit është një afat optimal që procedurat pengesat edhe të kohës edhe koha shumë e shkurtë, se veç e tetorit përfundoj, se di sa do të arrim me realizu ato që janë të planifikume të prezantimi analitik. Isha ndal rregullimi i fushave sportive 233 mijë e 611 euro. Sa fusha janë rregullu, se shumë e madhe po më duket. Nen 2 rregullimi i rrugëve me zhavorr 251 mijë euro. A janë bë me kubik apo me kilometra, se vetëm qëto dy, 1 edhe 2 diku po shkon 600 mijë euro që i kemi shpenzu të buxhetit. Tjetra çka më ra në sy e kemi ndërtimin e trotuareve dhe ndriçimi publik 199 mijë e 946 euro, 200 mijë euro. Unë sa e di nëse janë projekte 2 vjeçare, se është një trotuar në Goshicë që është fillu në fillim të vitit dhe hala fundi nuk i shihet, nuk dihet kur përfundon ai trotuar prej se ka fillu është prit me shumë entuziazëm të qytetarëve, por aq ngadal është tu shku që tashti ma shumë është tu bë pengesa në rrugë për ata që janë në trafik. Çdo ditë e kemi edhe Ballancë, Zhiti, për tjerat nuk e di, por besoj që do të kryhet. Numri rendor 11 13430,

shërbimet e ndryshme shëndetësore për kujdesje shtëpiake nga Karitasi, 196 mijë e 144 euro. Naftë për ngrohje qendrore 9745 euro është marrë për një afat kohorë më të gjatë apo, se e dimë që sezona e dhezjes ka fillu me 15. Edhe për këtë një sqarim. Faleminderit!

z.Jakup Demiri: Faleminderit kryesues! Pasqyrat financiare të këtij 9-mujori gjatë periudhës janar shtator 2021, janë inkasuar gjithsej të hyra vetanake në vlerë 840 mijë e 943 euro. Shkalla e inkasimit bazuar në planifikimin vjetor është 85.13% është një shkallë e mirë. Por, neve që na shqetëson fakti, është te puna e subvencioneve dhe shpenzimet kapitale që i kemi në përqindje të ulët, duke e pasur parasysh se pjesa më e madhe e këtyre, koha vetëm se ju ka kalu, nuk e di se sa do të arrin të rritet shkalla e përqindjes së këtyre dy kategorive subvencioneve dhe shpenzimeve kapitale. Pagesat për vendimet gjyqësore, shpenzimet për të gjitha njësitë buxhetore, e kemi kodin 11900 pagesa për vendime gjyqësore, janë 624 mijë e 33 euro. Deshta me ditë a janë të gjitha këto që kanë të bëjnë me sistemin arsimor për shkak një kontrate të mëhershme apo ka edhe ndonjë land tjetër. E dyta është, shpenzimet e rrymës. Drejtori i shërbimeve publike nuk qenka këtu, por me siguri janë 6-muaj që në Smirë, për Smirë po flas. Edhe Bekimi kryesuesi është nga i njëjti vend që edhe sot janë dritat, dhezë dritat, ndriçimi publik është aktivë në Smirë, ditën 2 ose 3 herë gjatë ditës dhe te shpenzimet e rrymës duke bërë krahasimet, kemi edhe një rritje të shpenzimeve, është arsyeja e rritjes së çmimit apo për shkak sasisë të madhe të kilovatit që është djeg, vetëm se kemi në këtë 9 muaj për 11 mijë e 997 euro rritje të shpenzimeve të rrymës kemi një masë të madhe të rrymës që e djegim gjatë ditës për ndriçim publik dhe kjo nuk është në rregull, se e nita drejtorin tu thanë po i prekin po i dhezin, nuk është punë qytetari aty, po nuk e di se ku është problemi, por problemin duhet ta zgjidhim. Shpenzimet e ndryshme shëndetësore janë afër 200 mijë euro, 196 mijë euro shërbimet kontraktuese, megjithëse një listë e shpenzimeve e kemi, por ju kisha dhanë një vërejtje, që disa nuk shihen, nuk lexohen, është një kodë 13440, shërbime intelektuale dhe këshilldhënëse 1068 euro. Nuk e di që ka qenë ky kodë më herët, a ka qenë ky kodë dhe çfarë shërbime janë pagu me këtë kodë, drekat zyrtare i kemi 26 mijë e 458 euro dreka. Po ju pyes a janë shumë në këto kohë krize 26 mijë e 458 euro shpenzime për dreka zyrtare. Besoj që në replikë do të hy te krahasimet e diferencave ndër vite.

z.Taulant Haxhiu: Pasqyrat financiare të buxhetit për periudhën janar shkurt 2022. Unë po e shoh që kemi rritje të shpenzimeve si e thave 890 e 342 euro. Unë po du me ditë, kjo rritje e pagave, mëditje 119 e 900 euro, këtu a i kemi edhe vendimet e gjykatave të përfshira këtu në 9-mujorin e parë. Unë këto deshta me i cek, por kolegët e mi Alia, nuk po du me i përsëritë. Unë më shumë kisha hi te përkrahimi i kodeve, shërbime, shtypje 6048, jo marketing. Është mirë që qytetari me ditë çfarë shërbime janë këto tashti kur të bajsh shërbime shtypje për 9 muaj ditë 6058 here 9 580 euro kemi veç shërbime shtypje në muaj që me ba me matë dikush për 9-mujorshin e parë si shumë mujore është e madhe, kemi shërbime kontraktuese 156 mijë e 219 euro, po më së shumti më habit fakti, kemi edhe mobilje te kodin 13501 41 mijë e 979 euro, kemi blej mobilje, a është mobilje te blemë për zyre apo çka janë, nuk po e kuptoj mobile për zyre, apo mobile telefon. Te kodin 13501 ki 49 mijë e 979 ki prapë mirëmbajtja e mobileve 10 mijë 707, domethënë këto mobilje që i kemi blej 41 mijë euro. Tashti duhet qytetari me bërë një analizë, këtu kemi pagu ka 1189 euro për mirëmbajtje mujore, 10 mijë e 707 e pjesëton me 9 muaj, del 1189 për mirëmbajtje të mobileve, po më doket diçka jo normale. Mirëmbajtja e ndërtesave, çka nënkuptojmë me këtë, kemi 163 mijë e 359 euro për 9 muaj, cilat janë ato mirëmbajtje qytetari duhet ta dijë kur ta shfaj këtë shifër 163 mijë edhe e pjesëton për muaj. Në bazë të pasqyrave financiare duhet me ditë çka janë 163 mijë e 359, drekat zyrtare janë 26 mijë e 459, që i bjen 3 mijë e 799 euro për muaj. Dreka zyrtare ditore më shumë se 165, duke e pa punën që një kryetar punon 20 ditë. Mu po më duken disa shifra shumë të mëdha që është mirë me na elaburu ti për me ditë qytetari prej ka është bërë kjo ngritje e shpenzimeve. Faleminderit!

z.Ilir Zuka: Faleminderit kryesues, te shpenzimi i buxhetit për periudhën e tretë, e ceku edhe drejtori i bujqësisë, përndryshe këto të tjerat të gjitha e kanë kalu mbi 80% e shpenzimeve. Më doket edhe Drejtoria e Urbanizmit ishte më poshtë, këtu te grumbullimi i mjeteve që patëm hyrje, këtu një falënderim edhe qytetarët që janë vedijsu që është obligim dhe duhet me u pagu, se si e paguajmë kekun, internetin e gjerat e tjera edhe

kjo është obligim që duhet me u pagu. Te këto kompanitë që i kanë prezantu bukur të njofshme, nuk dua me diskutu asgjë te to, por dua të lidhem te kjo lista shtesë që na e ka pru zyrtari i financave. Kam pas dëshirë me u kanë drejtori i financave këtu, po për fat të keq është i sëmur. Drejtor, këtu që po i bëni shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, që i keni edhe brenda vendit, transportin, domethënë për shoqëritë kulturo artistike nuk e di se si keni të drejt me pagu. Hini shikoni vitin e kaluar ose 2 vite përpara edhe këtë vit të njëjtën mënyrë funksionon edhe një klub që e keni, që po thirrni krejt në atë klub ose të barabart ose mos bëni kësi dallime 4800 euro ose 5000 euro i ka fitu “Kemajl Azizi” prej subvencioneve të Komunës së Vitisë, edhe 5800 ja keni dhanë këtu, po bëjnë 10600. KF “Vllaznisë” së Pozheranit i keni dhanë 8000 euro, keni thanë e ka përfundu për këtë vit se nuk kemi të drejtë ligjore, nuk e di se si po bëni dallime për një, po keni të drejtë për tjetrën. Jo krejt çka kërkojmë ne ju thuani që po ja u bimë njëfar fanele, jena lodhë me fanella, ndihmona që të mundemi me vazhdu garat.

znj.Majlinda Shabani: Faleminderit i nderuar kryesues! Në fakt kisha fillu komentimin për sa i përket analizës të cilën e kam bë te pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar Shtatorë 2022. Pak a shumë u diskutuan edhe prej shefave të grupit, siç e kemi parë tek pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësitë buxhetore. Shohim që te subvencionet kemi 58.22%, e cila si përqindje mendoj që është pak. E dimë se si komunë e kemi 4 tremujorsha, ku në fakt jemi në 3-mujorshin e 3, domethënë e kemi vetëm edhe një 3-mujorsh që me përfundu viti, edhe kur kemi hapësirë me shfrytëzu ekzekutimin e buxhetit. Mendoj që duhet me shfrytëzu këtë hapësirë. Nuk po du me thanë që është një lloj keqmenaxhimi, ndoshta është keqplanifikim për shkak që kam parë që te secila drejtori ekzekutimin e buxhetit e kemi në përqindje shumë të ulët. Unë në fakt i kam ndarë, po du me i fillu shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, ku në sqarimin e cila është kërku në mbledhjen për KPF, është dhënë sqarim, ku thuhet se te transporti është i përfshim transporti i nxënësve me shumë prej 7564 euro. Është shumë e konsiderueshme, e cila mendoj që i kish përfshi nevojat për sa i përket transportit, mirëpo se sa po zbatohet domethënë ky transport dhe sa po furnizohen nxënësat me këtë transport për shkak që po kemi probleme edhe ankesa të vazhdueshme. Shpenzimet e telefonisë fikse, unë nuk e di pse duhet me pas kaq shumë shpenzime të telefonisë fikse, kur e dimë që si komunë jemi të kyqur me rrjet, domethënë shpenzimet e telefonisë fikse janë diku me vlerë prej 6008, ndërsa shpenzimet të telefonisë mobile ku është kodi 13320 me shumë prej 12 mijë e 191 euro. Pse duhet me pas kaq shumë shpenzime për këto dy telefoni. Për mua është shumë e paarsyeshme. Nëse ka diçka që është NUK DEGJOHET në komunën tonë e që mundem me gjet, janë shërbimet kontraktuese tjera, domethënë këto shërbimet kontraktuese të tjera për çdo vit edhe në fakt te pasqyrat financiare që kam mujt me i pa, kanë qenë gjithmonë me vlerë shumë të lartë, ku e kemi kodin 13460 me shumë prej 156 mijë e 219 euro, ku në fakt në sfidimin që është dalë prej KPF-së, përpos sqarimeve që janë dhan, thuhet që një vlerë prej 9715 euro ka shku për shërbime kontraktuese tjera. Trajtimi i qenve endacak. Se si bëhet trajtimi i qenve endacak në komunën tonë, e dimë shumë mirë, kemi problem me qentë endacakë këtu po figuron dikund shumë 9000 euro mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve, domethënë është kodi 14050 është shumë prej 10707 euro edhe këtu kisha dashtë me ditë se çka është mirëmbajt, mirëmbajta rutinore është kodi 14060 në shumë prej 29375 euro. Fillimisht emërtimi, mirëmbajtja rutinore, unë nuk po e kuptoj ndoshta ish kanë mirë me qenë domethënë transmetimi i kësaj, mënyra pak më transparente. Po filloj te Zyra e Kryetarit, ku shohim që kemi rritje për sa përket ekzekutimit të buxhetit tek subvencionet në shumë prej 72%. Kolegia asambliste e përmendi edhe çështjen e bursave, ku e dimë që, çështja e bursave del direkt prej Zyrës së Kryetarit, edhe në fakt nuk ka fillu mu egzekutu hala buxheti për sa i përket bursave. Edhe këtu kemi shërbime kontraktuese tjera, administrata dhe personeli dhe prapë shërbime kontraktuese tjera 8022 euro. Edhe diçka që më ka ra në sy, kanë qenë pajisjet që janë blerë, si administratë me arsyetu shumë, po du me arsyetu shumë që ka qenë diku prej 7189 euro. Te inspeksioni kemi pajisje trafiku me shumë prej 24897 euro. Cilat fshatra janë pajis me shenja trafiku, me shenjëzim vertikal, horizontal, për shkak që unë nuk kam shumë njohuri. Kisha dashtë me ditë tek Zyra e Kuvendit Komunal, edhe këtu e kam parë për sa i përket përqindjes së ekzekutimit të

buxhetit, domethënë 4.33%, e cila mendoj që është pak, edhe kjo ndoshta deri në fund nuk e di a kemi me mujt me mrri 50%-in e ekzekutimit të buxhetit. Buxhet dhe financat, edhe këtu kemi shërbime kontraktuese tjera me vlerë prej 17755 euro. Nuk e di pse ka nevojë për kaq shumë shërbime kontraktuese tjera, kur e dimë që komuna i ka administratën edhe punëtorët e vetë. Zyra e Komuniteteve është mallra dhe shërbime, buxhetin e aprovum e kemi pas në kuvend 5 mijë euro, e në fakt shohim që kemi shpenzime 0. Pse duhet me qenë 0. Te bujqësia, pylltaria edhe zhvillimi rural, subvencionet 41.01%, do të thotë si përqindje është pak. Prapë te shëndetësia i kemi 58.14%, ku në fakt kam pas edhe rast familjar, ku në momentin që ka shku me marrë trajtim shëndetësor ka pas ndoshta problem edhe me vitaminë C e lere më me gjerat tjera. Lejet e ndërtimit, vetëm 520 euro. Nuk e di a janë tu lëshu leje të ndërtimit apo kush do qysh po do po punon në komunën tonë. Leje mjedisore i kemi 0. Pse gjithë këto ndërtime po ndodhin, ndërsa lejet mjedisore i kemi 0. Edhe për mua kjo është e paarsyeshme. I kemi edhe te prezantimi analitik i investimeve. Një diçka që nuk e kam shumë të qartë edhe nëse me lejohet kisha dashtë me marrë një informacion. Te hartimi i projekteve është vlera 138 mijë euro, ku gati krejt projekti në komunën tonë që e kemi pa, edhe te miratimi i buxhetit që e kemi pas ka qenë vazhdimësi e viteve të kaluara. Për çdo vit komuna jep vlerë 100 mijë e shumë më lartë për hartim të projekteve, ku në fakt kemi projekte që në komunën tonë ndoshta prej vitit 2009, 2010, që mos me i hi me i specifiku, janë të papërfundume. Mendoj që edhe kjo është një vlerë begi e konsiderueshme. Në moment që ne si komunë hartimin e projekteve, vlera 138 mijë euro është shumë e lartë për kosto, dhe mirëmbajtja e kanalizimeve, ujësjellësi. Për çdo vit kemi taksa të qytetarëve, kemi problematika, dhe në fund uji i pijshëm nuk është zgjidh. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Majlindë. Parimisht më shumë po shkojmë komente, shifrat edhe raportet financiare tregojnë saktësisht pagesat që i kanë shpenzu drejtoritë dhe shumica janë kontrata që lidhim kontrata, se ato kontrata janë aty ku ka shpenzime, janë shpenzu shumë aty ku nuk kemi hargjitë pare, nuk kemi ditë me i shpenzu.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Unë po ndërlidhna te pasqyrat financiare të buxhetit të komunës për periudhën Janar Shtator 2022. Unë drejtpërdrejt po shkoj së pari te të hyrat. Nga analiza për periudhën janar shtator, të hyrat vetanake për 2022 krahasim me vitin 2021 ka dikun rritje 24 mijë e 772 euro. Kjo është rritje solide, është në rregull gjithçka, mirëpo unë do të përqendrohem te Drejtoria për Buxhet dhe Financa, pika 2.1, tatimi në pronë, planifikimi 592520, ndërsa planifikimi 9 mujor 432320, ndërsa realizimi 355095 në bazë të përqindjes jemi në përqindje prej 82.14%, ndërsa vjetore 59% kur krahasojmë me vitin 2021 të hyrat nga tatimi në pronë kanë qenë 108.09%, pse është kjo rënie e këtyre të hyrave në tatimin pronë, pika 8.2 tek të hyrat Drejtoria e Shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, pika 8.2 të hyrat nga qiraja, objektet shëndetësore shuma e planifikuar për vitin është 8640 për vitin 2022 për 12 muaj, ndërsa shuma e planifikuar për 9 muaj është 6480, ndërsa realizimi është 0, arsyeja pse ka ardh kjo deri te realizimi 0, pse edhe 2021 është rasti i njëjtë edhe 2021 kemi qenë 00, po tashti besoj që ndërlidhet nënkryetari. Edhe te Drejtoria e Shërbimeve publike, pika 9.3 parashikimi publik, shuma e planifikuar për vitin 2022 është 6535, ndërsa planifikimi 9 mujor 4735, realizimi është vetëm 500 euro. Ne e dimë që parkimi nuk funksionon. Te shpenzimet të gjitha u ndërlidhen, te 624 mijë pagesa për vendime gjyqsore është mirë të specifikohen, të dihen se pse ka ardh deri këtu 624 mijë vitin e kaluar 375 mijë 9 mujor, se vjetori është 892 mijë. Plus po me intereson mu dallimi mes kodeve 1441 0 dhe kodi 119 0, pse këto janë shpenzime prej gjykatave, të dyat janë prej gjykatave. Te derivatet, vetura, edhe këtu kemi një diferencë më të madhe në këtë vit se sa vitin e kaluar. Këtë vit 9 mujor janë 42 mijë e 066.95, ndërsa vitin e kaluar kanë qenë 23095. Kemi një diferencë 18973. Pse çmimi nuk ka lujt 82%. Drekat zyrtare u ndërlidhen të gjithë, edhe unë po ndërlidhem, është një diferencë e madhe kur të vjen në përqindje i vjen 131%. Te drekat zyrtare, krahasimi mes 2022 dhe 2021, shpenzimet e informimit publik 2022 janë 00, ndërsa 2021, 14875 e 24 centë. A mos ndoshta nuk ka funksionu kjo zyre. Investimet kapitale në bazë të analizës së investimeve kapitale, këtu është një përqindje e investimeve kapitale diku 60 e diçka %, mirëpo unë sa shoh, këtu projekte shumica janë 50 e më tepër. Përqindja janë të viteve të kalume, nuk janë investime kapitale të këtij

viti. Merri analizoni të gjitha, janë shpenzime që janë bartë prej vitit 2021 në 2022, domethënë nuk është shfrytëzuar buxheti për investime kapitale, por janë shpenzime që janë bartë prej vitit të kaluar. Tek drejtori i inspeksionit tha se, shpenzimi i buxhetit për pajisje 43 mijë, mirëpo këtu në pasqyra shihet se janë 24 mijë e 897 pajisje të trafikut.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit z.Nexhat! Zakonisht kur i jep dikujt edhe mundohesh me i respektu edhe me i dhanë hapësirë, e mandej e teprojmë, e dyfishojmë, e trefishojmë kohën e limitime që e kemi, nuk ju ndërpreva me qëllim, por megjithatë është mirë me pas respekt prej krejt kolegeve, jo prej meje, se për mua edhe një javë ju pres, nuk është problem.

z.Musli Neziri: Kryetar, faleminderit, por unë mendoj që është koha e pushimit, nuk po gutemi me përfundim, sepse jo çdo seancë për gutë që ta përfundojmë më shpejtë edhe ta kontrabandojmë seancën. Unë kisha kërku pushim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Duhet të përfundohet pika është rregull.

z.Musli Neziri: Te kjo pjesa e pagesave të gjykatave që u cekë, shuma 624 mijë euro mendoj që jam pjesë e arsimit, edhe unë e di që pjesa dërmuese janë te arsimit, por u tha këtu mesa e pashë si nifare forme jemi tu marrë parën e komunës. Mendoj që marrëveshjet që kanë buru prej kontratave kolektive e kështu me radhë, dhe kjo do të na përcjell, sepse ne të gjithë mësimdhënësit e Komunës së Vitisë ende kemi nis landë tjera, asgjë nuk janë deri këtu çka kanë me u nis tjerat prandaj këto nuk janë parat e komunës, por janë parat e secilit për punën të cilën e ka bërë. Sa i përket te pjesa e buxhetit për të hyrat vetanake, në 3-mujorshin e parë kemi pas ngecje, 9-mujorshin po e shofim se ka një rritje, mendoj që është punë në këtë drejtim mirë dhe të investimet kapitale shof këtu 233 mijë, një shumë që është të rregullimi i fushave sportive, u tha edhe nga parafolësit cilat fusha, prandaj nënkryetar kërkova që me i ngutë pak, sepse shumat janë dhanë, fushat janë rrethu, te pagesat tashti po mendoj me ju bë pak trysni, sepse shuma e madhe. E dimë që një pjesë dërmuese e fushave janë kry, e nëse janë mbetëto që nuk janë kry, këto janë të fundit me sa e di, kështu e kame informatën. Tek pjesa e ndërtimit të ujësjellësve në Komunën e Vitisë, kjo 125 mije ndërtimi i ujësjellësve po qapojmë po me doket pak tek shkrimi sun po i precizojmë se çka, se ndërtimi i ujësjellësve. Na po e dimë, Taulanti po thotë që ujë nuk ka në midis Vitisë, e ne po flasim për ndërtimin e ujësjellësve. Ta merr mendja kur e keshyr në shikim të parë jemi tu bë naj far fontane me ujë, prandaj më mirë është kanjëher të shofim përpilimin se si po e shkruajmë, besoj që dalim mirë.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Do të bëjmë përpjekje të ju përgjigjem shkurtimisht, sepse shumica e pyetjeve e din përgjigjet. Taulant tha mobile, e ku shtojca thotë kuart, furnizim me inventar nëpër shkollat 29 mije e 998 euro, banka, mobile thotë furnizim me inventar në ambulancë 10 e 500 euro, mobile furnizim me inventar në inspeksion 1490 euro, e zbrethime shifra 41 mijë e 979. Diksh e tha çka nënkupton mirëmbajtje rutinore, e ku këtu thuhet mirëmbajtje e ujësjellësit dhe kanalizimeve të cilën e kemi një kompani kontraktuese e cila i mirëmban dhe shifra e saj të koka 19 mijë e diçka, dreka zyrtare. Krejt e dini këtë, se dy shoqëri sivjet “Kemajl Azizi” dhe “Anamorava” i kanë sjellë dy festivale në Komunën e Vitisë, që ne seancën e radhe ka me ja pru detale edhe kush i ka shpenzuar e ka sa, keni mu bind. E dini që është mbajt “Flakadani i Karadakut, e dini që kanë qenë ambasadoret e shtatë shteteve, e kanë vizitu Vitinë dhe shumë takime tjera të cilët kemi mu habit që kjo shumë, shumë del e vogël në krahasim me vizitat që janë be dhe aktivitetet që janë zhvillu. Duhet me kuptu një sen, pasqyrat financiare nuk mundet me i ndryshu, është një ngjarje që ka ndodhë, janë pagu dhe i ke këto. Ndërtim i ujësjellësve, ju jeni kanë në dijeni që e kemi pas një borxh CDI-së prej 125 mije euro në marrëveshjen e nënshkruar që është ujësjellësi i Stubllës, është i paguar këtu. Një prej këshilltarëve e tha se, në ambulancë mungon vitamina C. Ta kemi të kjar, obligative për barna esenciale është ministria, bile bile qaq jemi tregu zemërgjerë ndaj qytetarëve që, edhe buxhetin të cilin e kemi aprovu ju e kemi qu në mënyrë jo të distinkte, se na nuk e kemi obligim, po ata janë qytetarë të Komunës së Vitisë, a obligative për këtë janë ministria. U tha hartimi i projekteve, shuma shumë e lartë. Nuk ka projekt të detajuar të vitit 2008-2009, projektet detale ne

fillim vin si projekt ideor, tani paramasa, paralogaria, tani projektet detale janë kompanitë të cila lidhin kontratë dhe paguhen për të. Tash a është shume e vogël apo e madhe, këto shkojnë përmes Zyrës së Prokurimit. Këtu as që du me hi, e ka përgjegjësinë Zyra e Prokurimit. Nexhati tha se, na gëzojnë të hyrat vetanake, unë kam qenë një prej atyre që e kam thanë edhe ne komitet që, mu nuk me kanë gëzu mu, mu kane dokë shumë keq, edhe pse janë rritje 22 mijë. Baza që e mban komunën e të hyrave vetanake kemi ramje, arsyeja e ramjes është se, vitin e kaluar e kemi përdor përmbaruesin privat, këtë vit u kanë vullneti i qytetarëve dhe vullneti i qytetarëve është ky, nuk me gëzon mu të hyrat vetanake në rast se na u ka shtu regjistrimi i automjeteve që ishin një shifër bukur e madhe. Shtyllë që e man çdo komunë është tatimi në pronë. Këtu kemi një ramje. Unë kame bisedu me përgjegjësin, i kame kërku me bë një plan të veprimit urgjent dhe me shiku mundësinë, cila do të jet forma që me e forcu atë shtyllë. Projektet të cilët i ngriti Alia dhe disa këshilltar që janë shuma të mdhaja janë projekte dyvjeçare që janë kry vitin e kaluar e këtë vit, po pagesa ju është bë këtë vit. Shumica thatë investime kapitale, përqindja e vogël prej kur ekziston Kuvendi i Komunës së Vitisë shifër me të lart nuk ka pas kurr, naj kanë mundesu qeto projektet dyvjeçare edhe unë pajtohem po ta kemi të kjart se muajin e nëntë me pas 60 e diçka, kur e dimë se procedurat e prokurimit zakonisht deri ne Korrik zgjasin dhe tash është vlugi me i madh i punëve. Unë besoj se kemi me qenë mirë nëse shkojmë me këtë trend, shkalla e realizimit do të jet e mirë. Muslia e shtroj një çështje, nuk ka pagesë e cila bëhet në rast se nuk vjen fatura e vërtetuar nga ana e mbikëqyrësit për punët të cilët i përcjell në teren pa e kry, nuk guxon prej hetuesisë.

z.Berat Zuka shef i ZKF: Nënkrjetari shumicës se pyetjeve ju përgjigj. Sa i përket shpenzimeve për vendime gjyqësore, vetëm 3236.50 janë shpenzimet e defekteve te Drejtoria e Kulturës më hershme që kanë mbet disa pa pagu, kurse shuma prej 621 mijë e diçka janë shpenzime që rrjedhin nga kontrata kolektive, shpenzime të transportit dhe shujtës për personelin arsimor. Kemi afër 80 mijë mjete qe na janë ndarë prej buxhetit, pritet të ekzekutohen ditëve në vijim deri në fund të vitit do të shkon kjo shumë mbi 700 mijë, mobilet janë mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike, këtë e kemi problem edhe me Ministrinë e Financave kemi telashe nuk i korrigjojnë, kemi kode të mangta, duhet 13460 i kemi 4 shpenzime, i fusim në këtë kod. Këtu kanë hy edhe shpenzimet gjyqësore te paga komplet këto i ekzekuton direkt thesari, nuk i ekzekutojmë ne. Vendimet gjyqësore 3236 që nuk kanë hy te pagat, është te mallrat dhe shërbimet. Vendime gjyqësore janë 620 mijë, mirëpo paret çka kanë tepru nëpër programe, nëpër punëtorë që nuk janë marrë i zbritet 119, del diferenca. Paret e tjera punëtorët që i kemi pas, por që nuk kanë punu me ato total pasqyrat financiare i keni gjendjen faktike, i kemi edhe me arkiven komunale edhe me sistemin e zhvillimit ekonomik.

z.Valmir Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport: Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar këshilltar komunal! Fillimisht te çështja e drekave zyrtare, për shkak se Drejtoria e Kulturës normalisht e bartë një barrë të madhe, tek drekat zyrtare ndryshimi është në vitin e kalum, në vitin 2021 “Flakadani i Karadakut” është zhvillu onllajn dhe nuk ka pasur dreka zyrtare. “Flakadani i Karadakut” këtë vit i ka zhvillu afërsisht 8 mijë euro në dreka zyrtare. Po ashtu kemi pas 2 festivale ndërkombe të me pjesëmarrje të shumë shteteve, dhe natyrisht ato kanë pas edhe kosto. Aty ku ka aktivitete, vizita të ndryshme ka edhe shpenzime. Një çështje që e ngriti Iliri, te çështja e transportit, te Drejtoria e Kulturës janë përafërsisht të njëjta me vitin e kaluem edhe pse kontrata e vitit të kaluem ka qenë 70 cent për kilometër, kurse këtë vit kemi ngritje të çmimit, kemi 1.30 euro për kilometër. Jemi mundu me vendos limite edhe për ansamble, mirëpo Ilir, përveç sportit që është shumë i rëndësishëm, ti e din që klubi KF “Vllaznia” është organizata më e mbështetur prej të gjitha organizatave, edhe gjithmonë kemi pas konsideratë. Por edhe kultura është një pjesë shumë e rëndësishme me të cilën lirishtë mundem me thënë që, Vitia po krenohet edhe ansamblet tonë në të gjitha festivalet edhe ndërkombe të edhe kombëtare po rezultojnë me rezultate te jashtëzakonshme, edhe lirishtë mund të them që në aspektin kulturor edhe në aspektin e asambleve jemi kampion në nivel të Kosovës, prandaj pajtohem Ilir që, edhe për KF “Vllaznin” të ardhmen do të tentojmë ta mbështesim edhe me transport. Natyrisht Vitia i ka 22 organizata joqeveritare, edhe secila i ka kërkesat edhe nevojat e tyre, por jemi duke u munduar që

brenda kapaciteteve tona buxhetore të mbështesim secilën prej tyre. Prandaj edhe kërkesat edhe nevojat e juaja i mirëkuptojmë. Faleminderit!

z.Nexhat Halili: Unë nuk morra përgjigje te të hyrat nga qiraja në shtëpinë e shëndetit dhe për parkingun publik ose zyrtari kryesorë financiar edhe nënkryetari.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Pasi nuk e kemi drejtoreshën e shëndetësisë, me siguri kontrata nuk e paska pagu këtë vit.

z.Nexhat Halili: Po edhe në vitin e kalum 2021 i ki 00 te pika 8.2. Te parkingu i ki vetëm 500 euro në këtë vit, vitin e kalum i ke 600 euro, planifikimi është 6500.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Te parkingu e di që sivjet nuk i është dhënë dhe prandaj për atë e ki ashtu.

z.Adnan Ymeri, drejtor: Janë parkingjet e veçanta që i kanë marrë bankat.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Unë po e di që ku e ka theksin e veçantë, megjithatë duhet të shikohet mundësia e përmbushjes së kontratës, të cilën e ka barnatoren aty, nuk kemi çka e bisedojmë, vetëm ajo është te QKMF-ja, nuk ka tjetër.

z.Illir Zuka: Drejtorë nuk jam kundër kulturës ose kundër asaj çka e ceku drejtori. E di që ka aktivitete, më vjen shumë mirë, vetëm dashta me lidh, ne kur aplikojmë kur shpallen subvencionet, ne aplikojmë me një dokument që, shpjegojmë ku kemi mi hargju ato mjete, edhe në ato mjete shembull ky nuk mundet me ma hek sivjet mua udhëtimin, se unë e kam të raportume në subvencionin që e fitojë. Unë këtë e kërkoja, se si po ka drejtë, ku po e gjeni formën, se unë nuk jam kundër vetëm sportit mi nda e kulturës jo, larg asaj, po në qoftë se unë kur kam apliku e kam cekë këtu KF “Vllaznia” për 6 muaj hargjon kaq mjete për rrugë, nuk ka drejtë më Drejtoria e Kulturës me një fond tjetër me më pagu, se unë me këto ka me u mbulu kur ta dorëzojë raportin financiar është në atë. Unë për këtë po kërkoj se, si po e gjeni formën ju, se nuk jam kundër asaj, për mua ne ti ndihmojnë edhe jam për me ju ndihmu, po vetëm formën si pe gjejnë, se dola shumë keq, sikur me u kanë kundër.

z.Berat Zuka shef i ZKF: Sa i përket qeras, kjo nuk figuron tek shëndetësia, por figuron te Drejtoria e Shërbimeve Publike është e planifikime si kod i planifikimit, mirëpo më herët është mbledh dhe është kodu te shëndetësia, e tani te shërbimet publike.

z.Adnan Ymeri, drejtor: Unë 2 përgjigje i kam për Nexhatin. Pika e parë do të thotë, ky thotë janë të hyra 500 dhe 600 euro te parkingjet. Po, është e vërtet se, derisa isha duke e udhëhequr Drejtorin për Shërbime Publike kam dhanë leje për parkingje të veçanta për institucione financiare, në këtë rast janë bankat, ndërsa komplet parkingjet nuk e kanë kontratën, ndërsa dallimin që e theksove në mes 43 mijë eurove dhe 24 mijë si janë paraqitur në pasqyra financiare, është fakti se, këto punë ne i kemi ekzekutu fakturat i kemi pranuar, edhe zotimin e mjeteve i kemi bërë pagesa nuk është kry ende.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit! Është tashti edhe koha e pauzës, kjo pikë nuk votohet se është vetëm informatë. Në ora 2 kthehemi në seancë. Faleminderit shumë! Vazhdojmë me pikën e radhës, ju kisha kërku që të jemi zakonisht prezent deri në fund të seancën, përndryshe edhe lista nuk do të nënshkruhen me ardhje, po do të nënshkruhen në fund të seancës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit UBT dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës se Viti

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Faleminderit kryesues! Duke ju dëshiruar punë të mbarë të pasdites, para jush e keni një marrëveshje të cilën ja u kemi sjellë më një ndryshim të vogël që është, nuk e di saktësisht,

por me një muaj e kemi aprovu draft marrëveshjen, megjithatë për shkak të aspektit proceduralë është kërku që edhe marrëveshja të hynë përmes kuvendit, prandaj është në pyetje një dokument shumë i rëndësishëm të cilit do të ju besohet për hartim që i mungon Komunës së Vitisë. Është fjala për hartat zonale, prandaj e keni marrëveshjen këtu para jush. Besojë që me këtë jeni të njoftum edhe në draft marrëveshje, megjithatë kërkohet edhe miratimi nga ana juaj. Faleminderit!

z.Musli Neziri: Faleminderit nënkryetar! Ne para kësaj kemi votu një draftë marrëveshje. Ju thatë me pak ndryshime, atëherë ndryshimi veç ta dimë, ajo ka qenë e para, kjo e dyta, tashti: pse ka ndodhë kjo?

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Ajo ka qenë draft, kjo është marrëveshje. Në këtë formë e kanë kërku në aspekt juridik. Për mua qajo draft marrëveshje në momentin që e keni votu e ka marrë fuqinë juridike marrëveshje, por ashtu e kanë lyp Agjensioni Antikorrupsion në këtë formë dhe prandaj po dua të mos kemi problem dhe ngecje, rreth kësaj dhe e kam sjellë në kuvend. Faleminderit!

z.Jakup Demiri: Përshendetje për të gjithë! Ne si Lëvizje Vetvendosje edhe kur është votu atëhere ka qenë seanca e majitë dhe kemi votu një dokumentë për të cilën nuk e kemi lexu as atëher, por kemi vërejtje edhe tashtë përshkak të materialit, se pjesa më e madhe e materialit nuk lexohet, ka defekte edhe te leximi edhe te analizimi. Kjo ka qenë si draftë marrëveshje e cila është nënshkru këtu në kuvend komunal është votu, po në faktë e kemi votu një dokument i cili paraprakisht ka qenë i nënshkruar nëse nuk gabojë prej komunës dhe ministrisë, të cilën ministri e ka anulë po komuna nuk e di çka ka bë, kështu kam informata, mundem me qenë edhe i pasakt.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Më falë që po të ndërhy, por vetëm mos me hupë kohë. Nga ana e ministrisë e kemi konfirmimin e plotë se, konformë ligjit është dhe nuk e ka anulë, gjithçka është në rregull.

z.Jakup Demiri: Do të thotë ne po votojmë një dokumentë i cili si pe kuptojë është në kuadër të Planit zhvillimorë komunal, janë hartat zonale, po për të cilin ne e kemi piken e 6.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Nuk është në kuadër të planit zhvillimor komunal. Plani zhvillimor komunal është një dokumentë tjetër. Pas miratimit të planit zhvillimorë komunal kërkohet hartimi i hartave zonale. Hartat zonale me një fjalë do t'i zëvendësojnë planet rregullative detale që kanë qenë, prandaj disa komuna e kanë kry më herët. Ne për shkak të planit zhvillimor komunal na ka pengu që t'i bëjmë hartat zonale, për shkak se duhet me qenë me afatshmeri dhe e kemi pas afatshmerinë e shkruar te ish planit zhvillimor komunal, prandaj kemi provu ta kemi të kajrtë me një komision të cilën na e ka formu kryetari i komunës me kapacitetet të cilat i kemi në kuadër të komunës që të fillojmë hartimin e hartave zonale, megjithatë kapacitete nuk kemi të bollshme, por komisioni ka kryer disa punë të cilat do ti lehtësoj shumë njerëzve më profesional, në këtë rast UBT-së dhe do të jenë në bashkëpunim. Një ashtu e keni edhe të shenum dhe që është një dokumentë shumë i rëndësishëm edhe i kërkuar nga ana e qytetarëve të Komunës së Vitisë, për këto të cilat i kemi këto pengesa, Jakup, edhe unë kam vërejtje të panderpreme, por i kanë centralizu disa kompetenca, i kanë marrë me tonera e printera, tashti drejtëpërdrejt qendra vjenë i merr tonerat, vjen i merr nëpër zyre, na e regjistron sa po hargjohet dhe shumë here kemi problemin dhe sekretari i kuvendit Fatlumi përpjet shkallve e te unë, por zgjidhje nuk kam, se kështu i kanë marrë dhe tenderi jepet prej tyre, vjen veq i kqyr sa faqe i kemi shpenzu. Ju kërkoi falje për atë, nuk është që është bë qëllimisht po për shkak të aparaturës të cilën e kemi në dispozicion. Faleminderit!

z.Jakup Demiri: Unë problemet nuk i di, edhe nuk e thashë që është e qëllimshe nënkryetar. Nuk po e adresoj këtë faj, nuk po e cilësoj në fakt si të tillë edhe nuk e cilësova, por vërejtjet që i kemi, se ky proces deri tashti ka vazhdu jo boll transparentë. Sa i përket neve si lëvizje Vetvendosje edhe herën e kaluar kemi votu një dokumentë të ngutshëm, pa e analizu është kthyer prej atjehit, po thojnë që është problemi që ky nuk është draftë po është marrëveshje e bashkëpunimit. Tashti edhe marrëveshja me UBT-në që është a ka qenë dashtë të bëhet marrëveshja e tillë. Edhe a po shkelet Ligji i Konkurences këtu, përshkak se nuk e di tashtë a duhet të jepet mundësia edhe dikujtë tjetër të konkurojë, përshkak se ne kemi edhe informata të tjera që pak është edhe konfliktë interesi, nuk e di sa e ndalonë ligji. Unë po e thamë që ne e kemi trajtu të tillë, për shkak se në kolegjin

UBT punon edhe vajza e kryetarit të komunës sonë, është një prej arsyeve që unë e shof që është i ndikueshëm, por tashti a po shkelet ligji, tashtë nuk kemi pas kurrë një dokument në kuvend komunal të ish hartave zonale më herët se sa janë respektu, a kemi pasë një vlerësim të komplet të gjitha procedurave të cilat janë ndjekë në Komunën e Vitisë, a ju kanë përshtat Planit zhvillimor komunal, sa është shkel plani zhvillimor i mahershëm, tu i përfshi edhe hartat zonale në këtë rastë që i kemi nënshkrimin me marrveshjen e UBT-së, që po thojnë për me nënshkru ne këtu. Do të thotë ne i kemi edhe te faqja e fundit, komuna ka emruar stafin e mëposhtëm për grupin punues, bazë për projektin harta zonale komunale. Ne nuk e kemi asnjë emër këtu në dokument, nuk e di cili është stafi. Ne si Lëvizje Vetvendosje ndërsa UBT-ja i ka të paktën emrat këtu. Kush janë të kyqur në hartimin e hartave zonale si profesionista. Ne folëm edhe në KPF dhe mbetem që t'i kemi emrat se edhe aty thashë ne nuk mundemi me votu një dokument pa e ditë se kush do të jetë edhe në hartat zonale. Nuk e di se kush është profesionist në Komunën e Vitisë dhe që është i involvum këtu në këtë marrëveshje, me këtë kush është mbikëqyrës i këtyre. Unë e kam parë që është drejtori, por drejtori unë nuk e di që është i fushës përkatse. Edhe te puna e pagesave: sa do të kushtoj. Komuna e Vitisë paguan një shumë diku 72 mijë euro nëse nuk gaboj, se edhe është i përshkllim materiali, por një pjesë të pagesës e ka edhe UBT-ja. Tashti kjo puna e pagesës së UBT-së kanë do ta paguaj ajo ka me pagu veten eventualisht një çmim simbolik të dikujt dikujt që janë eksperta të vetë e krenjtë në fundë deshta me ditë edhe UBTja a ka kry ndonjë plan zhvillimor komunal. Në këtë rast, pasi jemi te kjo pikë, se e njëjta pyetje ka mu bë edhe te pika e 6 që e kemi. A ka kry harta zonale diku më herët apo është hera e parë që e kryen në komunën tonë?

z.Illir Zuka: Ne e kemi pasë para disa seancave këtë propozim vendim por tashtë është kush po i vleronë ato në ministri se ne e dimë domethan që prej 2013 jam pjesë e kuvendit me një rolë tjetër gjdo propozim vendim kur të vjen kur kalonë këtu prej propozim vendimit kalonë në vendim edhe merr formën e prerë është e nejte edhe kjo prej draft marrveshjes kjo ka kalu në marrveshje mirpo pasi e kanë kërku në këtë formë unë jam pro do të votojë pro edhe në këtë formë por megjithatë unë e di që nënkryetari si juristë është shumë i fortë edhe di ja u ka spjegu por tani me ditë kush po i vleronë këto se prej draft marrveshjes kur votohet ajo kalonë marrveshje prej propozim vendimit kur votohet ajo kalonë në vendim dhe ne i kemi kalu këto procedura se kjo është e nejtë edhe unë besojë nënkryetrë se edhe atë marrveshje kur të ja u derzojshë ti të njëjtën ke me ja u derzu se nuk ki qka ndryshon se aty kur e ke dorzu e ke dorzu si marrveshje se ka kalu në kuvendë.

z.Ali Bajrami: Kryesues unë do të ndërlihem me këtë ju paski pas debat dhe e kenë disku edhe në komitet ato qka jeni marrë vesh atje me siguri janë që janë përfill këtu edhe i kenë elaburu që prej draftit e kemi propozim vendimin ne e dimë edhe me planin zhvillimorë komunalë sa problemet i kemi pasë sa është zhagitë prandajë mos të jemi ne si kuvendë pengesë për me i shty proceset përpara por ato qka u cekë te emrat nëse duhet me qenë edhe është me ligjë e rregullume se nuk e di tashtë mos po kemi ndonjë problematikë nënkryetarë me votu ne si propozim vendim pa qenë emrat aty a bimë ndesh me ligjin me i shkru emrat masanej nëse jo ne si grup parlamentarë i LDKs do ta mbështesim dhe do të votojmë pro këti propozim vendimi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit z.Ali! Ne nuk jemi duke votu këtu komision ose grup ekspertesh po ne vetëm marrveshjen kjo marrveshje si e tregojë edhe nënkryetari nuk ka pasë nevojë hiq me ardhë sepse është votu dhe nga ministria është kthy që është e ligjshme parimishtë edhe në raportë atje nuk besojë që bënë 2 her 2 nënshkrime mirpo është kërku që edhe një herë të votohet që drafti mu bë marrveshje përmes kuvendit me kalu si procedurë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Kryesuesi e tha atë pjesën të cilët më ka pikë edhe para komitetit plotësishtë krenjtë atë të cilën e tha edhe Iliri, edhe kryesuesi është ashtu juridikishtë nuk ka forcë që mundet me më bindë që ka pas nevojë me ardhë ajo që u zgju, agjencia nuk thashë ministria, nuk e di a më ke përcjell Agjencia Antikorrupsion ka kërku, a ke aprovu draft marrveshje apo marrveshje edhe ka qenë pyetja a ke me dërgu marrëveshjen apert në kuvend, ju thashë jo, se u bë e më thanë që je obligativ me dërgu, edhe unë do ta dergoj, se nuk po du me më thirrë për një çështje të tillë. Më mirë po e përsëris 2 here, se me më thirr e me mu

grumbullu lloj lloj dokumenti. Çështja e komisionit është pjesë e ekzekutives. Unë pjesën dërmuese e di, më fal që nuk e pasna përmbush atë, se më paska ik. E di që është Xhevdet Halili, e di që është ky i mjedisit Albani, Xhelal Musa, inxhinierat e Komunës së Vitisë janë të përfshirë që punojnë këtu gjithësecili në sektorin e vet. Pikë kontaktuese do të jetë drejtori i drejtorisë përkatse, ndërsa të aspektit profesional çka kërkojnë, se ata munden me kërku edhe material shtesë, është obligativ ky komisioni i komunës tonë me ja ofru atyre. A i keni kqyr hartat e mëhershme zonale, nuk kemi pas kurrë, për herë të parë janë tu bë hartat zonale, nuk i kam shtru pyetje a kanë punu UBT-ja me ndonjë komunë tjetër. Harta zonale për Plan zhvillimorë komunal, Ajeti ndoshta është më në rrjedh, nuk është hera e parë në Komunën e Vitisë kanë bë edhe në komuna tjera, por a kanë profesionalizëm. Kujtoj në vizitë kam qenë me drejtorin me dytë po tregojë të drejtën më ka ardh mirë që kam pa një universitet privat me atë të merrem. Unë për vete kam studiu në universitet shtetror, çfarë biblioteke kam pa aty a shfletohen ato libra, mos më pyet, nuk e di, por çka kam pa aty me libra të pajisur mundet t'i bëjë konkurrencë edhe nivelit europian, e tashti në aspektin profesional Jakup nuk jam në gjendje unë me ja u mat veç kapacitetet njerëzore të profilit, kanë dhe besoj që e bëjnë mirë. Nuk besoj që është konflikt interesi, se çdo fëmijë i dikujt mundet me qenë. Themelues i universitetit UBT është dikush tjetër dhe në udhëheqje është dikush tjetër, edhe fëmijët e mijë mundet me qenë me ndonjë pjesë tjetër, nuk është këtu domethanja, por krejt ne nuk mundemi me i uzurpu ato, nuk besoj që paraqet se është me rëndësi që themeluesi i universitetit është dikush tjetër që nuk ka të bëjë asgjë me interes familjar.

z.Ali Bajrami: Unë tashtë jamë në dilemë, si kryesues po thua se nuk ka pasë nevojë me ardhë këtu hiq. Nënkyetri tha Agjensioni Antikorrupsion e ka kërku, tani a jemi obligativ me votu apo nuk jemi. Edhe nëse nuk është dashtë me ardhë pse e keni pru tani atë çka po e spjeron nënkryetari, qenka obligim prej Agjencionit Antikorrupsion që me ardhë edhe njëherë me u votu, me kalu procedurën e kuvendit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Ali, unë po them për mu marrveshja ka perfundu në maj edhe është kthi ligjshmëria, megjithatë në ekzekutiv, në rast se ki punë, nuk po du me u merr me antikorrupsion. Unë edhe 1 muj ditë bjere këtë se si ka kalu ka kalu si draftë marrëveshje, ja ku e ke ka kalu si marrëveshje, ja ku është dhe është kry. Nuk e di pse po e diskutojmë një dokument që e kemi pasë dy herë.

z.Ali Bajrami: Unë nuk jam tu e kompliku, unë pikërishtë jam tu e mbështet atë që ti pe thua. Nëse e ka kërku agjencioni, e keni pru e votojmë, edhe thashë si grup i LDK-së do ta mbështesim, do ta votojmë, shumë i kjartë jam.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Agjencioni nuk mundet me të obligu neve, unë e di se ju kam thanë atyre nuk munden me na obligu, por megjithatë nuk po du me u marrë me neve hiq. A e ki këtë dokument, po, qe.

z.Jakup Demiri: Deshta edhe njëherë me pyet. Unë kam hulumtu edhe vetë në internet dhe nuk kam mund që ta gjejë asnjë punim që u bë me ndonjë komunë. UBT-ja, hartat zonale, të paktën unë nuk kam has. Për atë edhe thashë, a keni ndonjë informatë konkrete dikund që e ka bë se unë sun e kam gjetë.

z.Reshat Azizi: Konkretishtë kur thua se ka punu nëpër komuna tjera, duhesh me ditë se në cilën komunë unë nuk kam njohuri që ka punu.

z.Ajet Sallahu, drejtor: Po në Gjakovë është tu punu.

z.Reshat Azizi: Jo insi e ka bë aty, nënkryetari tha për plan zhvillimor urban kanë bë. Unë bana pyetje konkretisht ku thave jo nuk e di.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Kur kam qenë në bisedë me ta, kanë thanë provojë të planit zhvillimor kemi, se nuk është komuna e parë që jep. Ke kuptu që ka edhe komuna tjera. Unë nuk e kam pyet detalishtë se, në cilat komuna ke punu edhe planin zhvillimor e kanë përgatit që është pranë edhe prej ministrisë, që sotë e kemi qitë në diskutim publik, por na e ka kthi ministria për shkak të formës së vet të cilën e ka unike në nivel të Republikës së Kosovës.

z.Nexhat Halili: Deshta pakë me u nderlidh te Agjencioni Kundërkorrupsion, arsyen se pse e ka kthy, e para, e dyta, mua tasht sa po mundem me analizu, po më doket se Zyra e Prokurimit është anashkalu, këtu të paktën është dashtë me shku përmes Zyrës së Prokurimit, me ju dhanë mundësia ofertuesve me konkuru mund të ndodhë që ka ndonjë ofertues tjetër që mundet me kry këtë punë. Arysja pse është anashkalu Zyra e Prokurimit nuk po mundem me perceptu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nëse është anashkalu procedura, për procedurë ka çështje tjera që nuk mirremi ne si kuvend, ka organe që merren, domethanë shkojn në përgjegjësi nëse i kanë kalu procedurat ne jemi tu e votu si marrveshje. Kjo marrveshje për me i bë hartat zonale, një marrveshje domethanë që është bë prej ekzekutivit edhe prej UBT-së. Ne nuk kemi përgjegjësi të procedurave, përgjegjësi të procedurave ka ekzekutivi, neve si marrveshje, domethanë ne këtë marrveshje që e kemi votu njëherë si draftë, këtë marrveshje me votu edhe njëherë, dhe jemi tu e diskutu sot për procedura është çështje tjetër. Domethanë që i bjen, përgjegjësia, nese nuk i kanë udhëheq procedurat atyre tjerëve nuk ka çështje me kuvendin.

z.Nexhat Halili: E dimë që nuk ka, po ne po votojmë diçka që nuk jemi tu i respektu procedurat.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Procedurat i përcjell tjetër kush.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Mua po më vjenë zor, se ne e kemi votu njëhere, ne po dojmë me i vërtetu disa njerëz të cilët jan interesu, disa që kanë mëndu që i këna tejkalu procedurat kanë shku në Agjension Antikorrupsion, janë anku për këtë çështje dhe kur i kam dhanë unë dokumentet tona edhe draftë marrveshjen edhe konfirmimin ligjor kanë thanë me na falë dhe pyetja ka qenë shumë decidive, se me mu kanë bisedu në telefon a e shtinë edhe marrveshjen në kuvendë në raste se thuni e shti po, nuk ka nevojë jo më thanë duhesh me shti edhe e kam pru .

z.Nexhat Halili: Ne më herët kemi votu draftë marrveshje dhe atje kur ka shku si draftë marrveshje ose nëse këtu e ke votu si draftë marrveshje dhe të ka shku në Agjencion kundër korrupsion ta kthynë me bë marrveshje unë po potencioj këtë janë anashkalu procedurat, nuk e di unë a ka pasë të drejtë ky me nënshkru në këtë mënyrë, nëse e ka nënshkru në këtë menyrë që mua po më duket është e jashtëligjshme.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Jo Nexhat, nuk është e jashtëligjshme, se marrveshja bashkëpunimi ka të drejtë, ju e keni votu edhe me Kllokotin e kemi votu një marrveshje bashkëpunimi me strehimoren “Liria” ani pse është shuma më e vogël.

z.Ajet Sallahu, drejtor: Pak po përzihen konceptet, kshilltaret komunal kanë të drejtë se nuk janë profesionist, janë në lami të ndyrshme dhe janë dokumente të ndryshme. Plani zhvillimor komunal, harta zonale, plani rregullues në detaje janë koncepte të ndryshme edhe dokumente të ndryshme. Ne sot jemi tu folë për një marrveshje bashkëpunimi, jo tender po marrveshje bashkëpunimi. Tender kur të ka, atëherë procedurat e tenderimit shkojnë nëpër Zyre të Prokurimit. Marrveshjet e bashkëpunimit i nënshkrun kryetari, i ratifikon kuvendi. Këta deshta me skjaru se nuk është çështja për tender.

z.Jakup Demiri: Drejtor, e kuptoj punën që nuk është tender, por është marrveshje. Po sikur ta kishim bë tender për marrveshje, besoj që e kishim nxjerr më të mirën të mundshme. Kuptoje se është batut, se po e bënë një marrveshje me dikan dhe po ma bjen mua këtu sikur ti kishum pas 3-4 ofertues për me bë, këtë besoj që kish dal dikush shumë më i mirë se ky, se të paktën e dimë që është një institucion në Kosovë që ka bë, ka bë shumë bile edhe e ka stafin më të mirë në Kosovë ISPE shumë më të mirë se të këtyre. Hyn hulumtoje, kqyrjav edhe burimet njerëzore edhe pajisjet edhe të gjitha, për atë po them e ke pru marrveshjen qysh e ke pru dili në kry. Nuk po them kurgja. Edhe vitin e kalum ju kemi thanë disa here në fund tana ju ka dështu krejt.

z.Nexhat Halili: Vetem pak drejtor je tu pagu, mu kanë që nuk pagun e bënë marrveshje është diçka tjetër, por je tu pagu, ki me pagu këtë për 75 mijë euro, edhe marrveshjet që bëhen me Komunën e Kllokotit nuk ceken mjetet financiare, këtu ceken mjete financiare.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Me strehimoren “Liria” ceken edhe mjete fianciare edhe me CDI-në.

z.Ramadan Deliu: Vetem hini lexoni, 7 komuna paskan bë marrëveshje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit shumë, faleminderit për gjitha sqarimet! Unë e qes në votim: kush është për këtë marrëveshje? 8 janë pro. Kush është kundër? 8 janë kundër. Atëherë me votën e dyfishtë të kryesuesit të kuvendit komunal miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit Nr.01-110/05-110, të datës 01.02.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan dega në Viti

z.Ajet Sallahu, drejtor: Në këtë kuvend ky propozim vendim, e që më vonë është bë vendim, ka kalu edhe është shpall i ligjshëm nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal, mirëpo sygjერი i Agjencionit Kadastral të Kosovës për me regjistru këtë si pronë, dhënie në shfrytëzim Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti është dashtë të bëhet kërkesa nga Këshilli Gjyqësor dhe pas dhënies së tij na u kanë sygjeru që të bëhet propozim ndryshimi i këtij vendimi dhe ti shtohet jo caktimi i lokacionit, por dhënia në shfrytëzim e pronës komunale në afatgjatë për 99 vite. Prandaj ky kish me qenë ndryshimi, ndryshimi është në nenin 2 që e keni në material, çështjet tjera nuk ndryshojnë, ka kalu kjo në kuvend, është shpallë i ligjshëm, mirëpo në vend të caktimit, lokacionit duhet të jetë dhënie në shfrytëzim e pronës komunale. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtë vendim në seancën e parë e kemi votu, e kemi caktu lokacionin, mirëpo pasi që gjykata është e ndamë nga komuna, tash është kërku që të shënohet koha për shfrytëzim, sepse nuk i falet gjykatës por i jepet në shfrytëzim

z.Jakup Demiri: Po këtë dokument e kemi votu edhe ne si Lëvizje Vetvendosje, gjithësesi i kemi pas disa vërejtje edhe atëherë, se lokacioni ka qenë edhe me çerdhen disi si i ndarë por e morra fjalën këtu për të pyet se çdo dokument që po e votojmë po na vjen me ndryshu diçka edhe nuk po më duket që është kogjo e pakapshe, kështu që është në herën e parë me kry këtë farë pune. A ka Zyre Ligjore zyrra e komunës apo drejtoria a ka kapacitete që këto dokumente mos të na u kthehen vazhdimisht, se ndoshta edhe po vonohemi në kohë me shumë sene, se këtë e kemi votu nëse nuk gaboj në muajin Shkurt ose Janar. Veç e dij që ka qenë qashtu diçka dhe tashti jemi në fund të muajit 10, gjithë kjo kohë me shku e me na ardhë dokumenti për kaq ndoshta nuk i falet dikujtë. Mos e merrni shumë personale, thjesht vërejtje se shumë e dokumenti po na vjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht vendimi si vendim, caktimi lokacionit ka qenë në rregull po është dashtë me u shtu edhe një nën që jepet në shfrytëzim për kaq, se ti nuk ke mujtë me ja falë gjyaktës, domethanë nuk është shkru që i jepet në shfrytëzim për kohë të caktume dhe atë plotësim tani po e bëjmë.

z.Jakup Demiri: Nuk e specifikova mirë ne e kemi pasë atëherit telashe më shumë për shkak të qerdhes për shkak të vendit që është i frekuentum shumë dhe gjykata e qerdhja me një vendë veq të jeni të bindur se kur të vjen puna e qerdhes ka me ardhë edhe ai dokumentë prap kështu.

z.Illir Zuka: Një kolegë këtu në kuvendë patë thënë që po i votoni propozim vendimet pa e lexu materialin hiq, unë për herë të parë po e votoj pa e lexu materialin hiq, për arsye se ishte i palexueshëm, kështu që edhe për çerdhe deshta me cek po e the, por e kryte ti nuk ka me pasë problem, sepse çerdhja ka shku në Koretin.

z.Jakup Demiri: I kemi 4 çerdhe në rend qe nja 10 vite që jeni tu na premtu të him njëhere në ato e tani i bëjmë ato tjerat mos të harrojmë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Edhe njëhere, te materiali me pas pas me lexu përime edhe në e-mail e keni materialin, krejtve ju ka ardh, përposë fizikisht edhe në e-mail.

z.Illir Zuka: Kryesues 50% e asamblistëve kanë probeleme me e-mailët zyrtare, e kam thirr disa here zyrtarin që është edhe nuk ka ndermarr asgjë, kështu që bëjë lutje te ti se ndoshta vinë edhe shkresa të tjera, por ne nuk kemi qasje në e-mailin zyrtar të Komunës Vitisë, kështu që si kryesues i kuvendit të bëj lutje që me u marrë me zyrtarin i cili e ka përgjegjësinë e kësaj pune. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Me ngritje të dorës kërkoj miratimin e këtij vendimi. 15 prezent, 15 pro, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, atëherë kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit Nr.01-110/05-1067 të datës 28.09.2022, për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën kadastrale në Viti, Radivojc dhe Sllatinë

z.Ajet Sallahu, drejtor: Faleminderit kryesues! Unë nuk e di a ka nevojë me elaboru, sepse edhe kjo ka kalu një herë në kuvend nëse ka nevojë nderkohë munden më bë pyetje, mirëpo për atë që na është kthyer prej Ministrisë së Pushtetit Lokal, që Ministria e Pushtetit Lokal na e dërgon nëpër ministria të linjës këtë e ka kthi Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. Unë kam qenë dhe kam bisedu me ta dhe e pash kur erdh fundi që nuk kishin çka me thanë, më thanë shtonja edhe një nen edhe mua më është dokë aq e panevojshme, sepse ligji i parashe këto gjëra. Në propozim vendim thotë se, duhet të shtohet edhe një nen që obligohet kryetari i komunës, që pas hyrjes së këtij vendimi t'i bëjë kërkesë Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës për udhëheqjen e procedurave të shpronësimit të parcelave të tyre. Domethanë që këtë ligji e përcakton. Sipas menidmit tem nuk është dashtë të jetë vendim, mirëpo për këtë na e kanë kthi, edhe lus që ta votoni edhe këtë plotësim ndryshim të këtij propozim vendimi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë mendojë që ky nen është mirë se ne edhe më herët dy her i kemi shpallë zonë me interesë që mos me u shitë këto prona që është fjala varrezat e deshmoreve dhe shkolla mirpo ky nen ndoshta na jep mundësi me fillu një procedurë për me rikthi si pronë komunale mirpo unë besojë që është një plusë që mundet me na e dhanë si mundësi se veq ne e kemi bë si zonë për interes mirpo nuk e kemi lanë mundësin ndoshta për me fillu procedurë ky nen ndoshta na shtin me bë një procedurë ndoshta nuk jam profesionistë por ndoshta na kish dhanë një mundësi me bë një procedurë për me vazhdu në të ardhmen.

z.Ajet Sallahu, drejtor: Një sqarim ne e kemi marrë pëlqimin prej agjencionit privatizimit pëlqimin na e ka dhanë pastaj që është prona e AKPs ligji e thotë që kujdeset ministria përkatse në këtë rastë ministria e mjedisimit planifikimit hapsinorë dhe infrastrukturës komuna nuk mundë ta bëjë shpronismin edhe për parcelat jeni tënjoftun sigurishtë pasi ka kalu një here në kuvendë nuk po hi në dataje nese ju interesonë mundem edhe një here me përsërit mirpo pasi e kanë kërku unë ka me shku në këtë mënyrë.

z.Ramadan Deliu: Unë e kam një vretje te qeveria jo kanë thanë mundem ja nuk munden jo bën jo nuk bën mos i përzini senet e ke pru në kuvend duhet me votu nëse nuk ka nevojë nuk e bjën në kuvendë hiq e nita ehde parzit 30 minuta bisedumë jo duhet jo nuk duhet krye punën është me votu e bjenë në kuvendë nuk është me votu nuk e bjen hiq Faleminderit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë mendojë që qdo vendim që është në interes i qeverisjes nuk do të thotë që është interes i gjithë qytetareve edhe që duhet me votu kuvendi mirpo këto binë vendime edhe interesi i përbashket i votonë edhe i qetë përpara mirpo ka raste që nuk i votojmë sepse ashtu e vlersojmë kështu që është mundësi e pa varurë e votimit me ligjë që i garantohet qdo këshilltari për atë edhe ne vetëm po e diskutojmë se është interesë me i diskutu edhe me pasë skjarime se për shumë gjera mundemi që të mos kemi sqarime por me diskutim mundë të marrim sqarim dhe ta kemi më të kjashtë , e qesë në votim këtë pikë të rendit të ditës kush është për, me 14 vota pro, kush është kundër 1 , abestenim nuk ka kalonë kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6.Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shqyrtim publik projekt Planin e Zhvillimor Komunal të komunës së Vitisë 2022-2030.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Edhe ky propozimë na është kthi që nuk është zbatu procedura mirë.

z.Visar Demiri: Faleminderit kryesues, ky propozim vendim është kthyer përshkak të formës më shumë jo për shkak të përmbatjes nga seanca e kaluarë ministria kishë një shabllonë me të cilat po i bëjke propozimë vendimet për PZHKn materialin besojë që e kani marrë me kohë propozim vendimin me këtë propozim vendimë kërkojmë shpalljen në shqyrtim publikë të planit zhvillimorë komunal 2022-2030 shqyrtimi publikë do të zgjasë 30 ditë gjithashtu do të organizojmë shqyrtime publike edhe neper disa bashksi lokale Faleminderit.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: veq një korrigjim proceduralishtë e ke udhëheq mirë edhe ekzekutivi edhe ti vetëm në formë vendimi na është kthyer jo në procedurë vetëm në formë na është kthyer.

z.Jakup Demiri: Këtë dëgjim publikë nuk po e zgjasim më shumë vetëm se te dëgjetimet publike është Viti Pozheran Smirë Sllatinë e epërme Gjylekar dhe Stubell ndërsa mendojë që mirë është me pas ndegjim publikë për Verban Sodovinë ndoshta me përfshi edhe Germoven aty për shkak se po mbetet si e pa përfshime ajo pjesë aty për dëgjime publike

z.Visar Demiri, drejtor : Si bashksi lokale është që e përfshin Germoven përshebull Smira ose Verbani këto shkojnë me Smirë bashkë , do të përfshihen të gjitha fshatrat po e kemi mëndu nëpër bashksi lokale.

z.Musli Neziri: Faleminderit, drejtor ju thatë që përshkak të procedurave e ka një shabllonë thatë a nuk e kemi ditë shablloni që është që me u konsultu me kry me të parën se kjo nga 2 here.

z.Visar Demiri: Unë e kam mandatin e dytë si drejtor vetëm kurr propozim vendim shabllone nuk kemi marrë prej ministrisë është hera e parë që ata e dergojnë dhe është një propozim vendim i Gjakoves që e kanë bërë dhe tashtë luajnë me qdo komunë ju thonë qështu bëje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mos me u kanë asgjë nuk na e kishin kthyer

z.Visar Demiri: I kthejnë edhe për asgjë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ju kisha lutë sinqerishtë edhe shabllona nëse ka ministria që mos të na u kthehen 2 herë në procedurë se 1 muaj i kemi hupë në diskutim publikë për një mos kujdesje.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Kryesues vetëm një sqarim nuk po du me mbrojtë drejtorin realishtë se nuk ka ekzekutivë edhe kuvendë që nuk e ka shërbimin juridikë të vetin dhe shërbimi juridikë i veti e ka formën e vetë të cilët ja u sjell vendimet këtu me krejtë këtë provojë edhe unë nuk e kam ditë që ka shabllone që e obligojë se zakonishtë kur i kanë shabllonet në fillim viti i dergojnë për diqka duhet me respektu këtë dhe ka ardhë është ardhë Fatlumi e kanë kthyer për këtë po kerkojnë e kqyr krejt i ka pjesët te cilat duhet ti ketë një propozim vendim për me dalë në shqyrtim publikë por me gjithatë unë e dijë po e përdori këtë rastë se jemi në përfundim gjatë studimeve të cilat juristat që kanë pasë rastë me pa Esat Stavilecin thojkë mos harro se ti je vllau i vogël e të drejtë me ta prishë vllau i madhë ka kur të donë vëlla e kemi edhe ministrinë kanë thanë ashtu edhe u kry.

z.Ramadan Deliu: E ke prurë në kuvendë votoje ose mos e voto edhe ditën e mirë.

z.Illir Zuka: Unë po mendojë mirë tha kryesuesi Ramada i qe 2 herë po nderhynë ne jemi koleg jemi bashkpartiak por megjithatë debati sjellë diqka më mirë nuk mundemi ne me qitë vetëm me votu shabllonë paraprakishtë është kanë mirë edhe drejtori me pyet ministrien përshebull se është hera e parë që po bëhet diqka me marrë që kur kishë ardhë në kuvendë nuk kishë pas nevojë më me u kthyer se kemi pasë raste të tjera nënkryetarë edhe ish kryesues që shumë here kemi diskutu ne me ministrinë që përshebull se si shkonë kjo formë kur e kemi prurë në kuvendë që mos me na u kthyer po nuk është diqka e madhe kalon ka kalu një muajë.

z.Ramadan Deliu: Unë nuk thashë mos me debatu unë thashë mos me thanë duhet ndashë votone ndashë mos e votoni jo shablloni po shablloni e ke prurë në kuvendë diskutoje me votu.

z.Durim Sylejmani: Është shqetësuese fakti që 50% të vendimeve ja u kthen mbrapsht MAPL për plotësim ndryshim nuk po më vjenë qudi prej juve të PDKs se ju frikë jeni në ekzekutivë sa ja keni nisë por po më vjenë qudi prej këtyre LDK qe 9 vite o burrë nuk u msunë me marrë vendime qysh duhet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk mundet me pasë përgjegjisi kuvendi pse e votonë një vendim mos harmonizimi domethanë janë persona që na e binë neve materialin dhe e pregaditim prej drejtorive prej zyreve

ligjore edhe vine te ne , nuk është 50% të jeshë i bindur që më së paku kemi në Kosovë se na e kanë pru raportin që janë të krejt kuvendeve që kemi të kthyme përpos këta të fundit që i kemi një e kemi pasë më herët por nuk kemi të kthyme mirpo sa i kemi të kthyme dhe sa i kemi marrë në seancën e ardhshme do të ja u japim një informatë.

z.Visar Demiri: Durim qeveria e praktikatave është naltë ne jemi kanë edhe 2007 2010 në qeverisje kështu që nuk jemi të rijë për sa i përket këtij propozim vendimi mos ti përzim gjerat ne e bëjmë propozim vendimin në bazë të udhëzimit administrativë dhe në bazë të atijë udhëzimit administravë ne i shkëput gjërat qe duhet me qenë propozim vendimë ajo se ministria qonë shabllone atë e përdor vetëm fuqin si nivel i dytë që është shpeshë here me na shty përndryshe është antiligjore atë qka ka kërku ministria përshkak se udhëzimi administrativë vlenë edhe për ta edhe për neve dhe në udhëzim administrativë shkrunë qartë se qka duhet të përmbajë një propozim vendim për këtë

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk është në rregull me diskutu në atë formë se nuk e ka kthy ministria nuk e ka kthy ministri po e ka kthy një zyre ligjore që është përgjegjes ata të zyrës jan puntor teknike janë puntorë juridike janë puntor që e kanë për detyrë domethan nuk ka aspekte politike te vendimet që kthehen duheni me ditë.

z.Ajet Sallahu: Me rendesi që asnjë nuk është kanë shkelje ajo është me rëndesi.

z.Musli Neziri: Mos ti jes borgjë Durimit se po kujdeset mirë për PDKn kështu që ju faleminderit Durim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kisha kërku me ngritje të dorës kushe eshte pro me 14 vota pro, kush është kundër 1 , abestanim nuk ka kalonë kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi